



USHTRIA



Viti i 75-të i botimit Nr. 9 (827761)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 11 Mars 2022

“Krenohemi me gratë në uniformë për kontributin e tyre në forcimin e paqes dhe sigurisë”

Në takimin e organizuar me rastin e 8 Marsit nga Forcat e Armatosura shqiptare dhe Zyra e Bashkëpunimit të Mbrojtjes, morën pjesë ministri Niko Peleshi, ambasadorja amerikane Yuri Kim, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Bajram Begaj, zëvendëshefja gjeneralmajor Manushaqe Shehu, komandantja e Gardës Kombëtare të New Jersey-t gjeneral brigade Lisa Hou si dhe mjaft gra dhe vajza ushtarake si nga FA-të shqiptare ashtu

dhe nga ato amerikane. Në fjalën e tij ministri Peleshi vuri në dukje jo vetëm rritjen e numrit të grave në FA-të shqiptare, por edhe fuqizimin e rolit të tyre, në përgjegjësi të reja dhe detyra të larta. “Ne krenohemi shumë për gratë tona të guximshme në uniformë për kontributin e tyre të shkëlqyer. Shqipëria mbështet plotësisht rëndësinë e rolit të gruas në forcimin e paqes dhe sigurisë. Sidomos gjatë viteve të fundit, për shkak të prioritetit të lartë që i është

kushtuar fuqizimit të grave dhe aritjes së barazisë gjinore, Shqipëria ka bërë progres të dukshëm në rritjen e kuotave të grave në parlament, administratë publike, ushtri, polici dhe gjyqësor. Në përputhje të plotë me Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planin Kombëtar të Veprimit 1325, Ministria e Mbrojtjes ka përfshirë perspektivën gjinore në politikat dhe procedurat e saj të rekrutimit duke promovuar dhe rritur leadershipin e... »

faqe 2



SHBA aktivizon në Shqipëri Shtabin e Forcave Speciale për Europën Ministri Peleshi: Rëndësia e vendosjes së këtij shtabi i kalon ‘kufijtë’ e vendit tonë



faqe 3

Gjeneralmajor Manushaqe Shehu: Krenare që i kemi shërbyer me përkushtim e devotshmëri atdheut

Për ju koleget e mia që militoni në Forcat e Armatosura! Ky 8 i gjen femrat ushtarake e civile të cilat shërbejnë në FA, në misionet paqeruajtëse jashtë vendit, në kuadër të NATO-s, OKB-së, BE-së, që nga Sudani i Jugut, Kosova, por edhe në shtabet e NATO-s e Përfaqësitë Ushtarake jashtë vendit. Që nga nëntori i vitit 1977, Kombet e Bashkuara (UN), 8 marsin e kanë njohur botërisht si “Ditën e Gruas”, ditë kur të drejtat e gruas u vunë në agjendën e ditës të politikës mbarëkombëtare, për shkak se që më...



Faqe 4

Myslim Pasha: Sistemi gjeodezik i standardeve të NATO-s, realitet krenarie

Shqipëria ka një datë me shumë sdomethënie në historinë e saj, ndoshta që prej Pavarësisë. Dhe kjo ka të bëjë me gjeodezinë, krijimin e këtij institucioni kaq të rëndësishëm. Instituti do të hartonte politika të grumbullimit, përpunimit, mirë-administrimit të informacioneve gjeografike dhe të gjeosistemeve në shkallë vendi. Ai organizonte përgatitjen topogjeodezike të terrenit shqiptar, përgatitjen e literaturës topografike e gjeografike ushtarake për...



Faqe 6-7

Arma e “besuar” e Putin, që po vret rusët në Ukrainë

Fillimi i pushtimit dhe marrja e vendimit për ta filluar luftën, sigurisht ka qenë një proces i gjatë vlerësimi i situatës në Ukrainë nga drejtuesit e lartë të shtetit dhe të ushtrisë ruse. Njohja e armikut, e aftësive dhe mundësive, e moralit dhe e pajisjeve të tij, është pika e parë në marrjen e vendimit luftarak ushtarak. “Nëse nje armikun dhe vetveten atëherë nuk duhet t’u frikësohesh qindra betejave”, -na mëson Sun Tzu në artin e Luftës. Kjo detyrë ishte ekskluzivisht...



Faqe 10

TAKIMI I ORGANIZUAR ME RASTIN E 8 MARSIT NGA FORCAT E ARMATOSURA SHQIPTARE DHE ZYRA E BASHKËPUNIMIT TË MBROJTJES

Ministri Peleshi: Krenohemi me gratë në uniformë për kontributin e tyre në forcimin e paqes dhe sigurisë

Në takimin e organizuar me rastin e 8 Marsit nga Forcat e Armatosura shqiptare dhe Zyra e Bashkëpunimit të Mbrojtjes, morën pjesë ministri Niko Peleshi, ambasadorja amerikane Yuri Kim, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Bajram Begaj, zëvendës shefja gjeneralmajor Manushaqe Shehu, komandantja e Gardës Kombëtare të New Jersey-t gjeneral brigade Lisa Hou si dhe mjaft gra dhe vajza ushtarake si nga FA-të shqiptare ashtu dhe nga ato amerikane.

Në fjalën e tij ministri Peleshi vuri në dukje jo vetëm rritjen e numrit të grave në FA-të shqiptare, por edhe fuqizimin e rolit të tyre, në përgjegjësi të reja dhe detyra të larta. “Ne krenohemi shumë për gratë tona të guximshme në uniformë për kontributin e tyre të shkëlqyer. Shqipëria mbështet plotësisht rëndësinë e rolit të gruas në forcimin e paqes dhe sigurisë. Sidomos gjatë viteve të fundit, për shkak të prioritetit të lartë që i është kushtuar fuqizimit të grave dhe arritjes së barazisë gjinore, Shqipëria ka bërë progres të dukshëm në rritjen e kuotave të grave në parlament, administratë publike, ushtri, polici dhe gjyqësor. Në



përputhje të plotë me Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planin Kombëtar të Veprimit 1325, Ministria e Mbrojtjes ka përfshirë perspektivën gjinore në politikat dhe procedurat e saj të rekrutimit duke promovuar dhe rritur leadershipin e grave në hierarkinë ushtarake duke emëruar gratë dhe vajzat ushtarake në poste të nivelit të lartë; duke rritur pjesëmarrjen e grave në misione dhe operacione jashtë

vendit; duke rritur e numrin e grave në Përfaqësitë Ushtarake shqiptare pranë strukturave komanduese të NATO-s dhe numrin e grave në përfaqësitë diplomatike jashtë vendit. Një nga politikat kryesore në FA është rritja e pjesëmarrjes së grave në misionet dhe operacionet paqeruajtëse jashtë vendit, parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve. Më lejoni të kujtoj pjesëmarrjen ushtarake të femrave në misionet paqeruajtëse dhe operacionet në terren si në: Letoni, Kosovë dhe Sudanin e Jugut.”

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Bajram Begaj e konsideroi shumë të rëndësishëm rolin grave dhe vajzave në uniformë dhe vlerësoi shërbimin e tyre.

Më pas, ministri Niko Peleshi, ambasadorja amerikane Yuri Kim, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Bajram Begaj, zëvendës shefja gjeneralmajor Manushaqe Shehu, komandantja e Gardës Kombëtare të New Jersey gjeneral brigade Lisa Hou ishin pjesë e një paneli, ku iu përgjigjën pyetjeve të ndryshme të grave dhe vajzave ushtarake që shërbejnë në uniformë.

Komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ylli Pulaj zhvillon takim me ushtaraket dhe punonjëset civile të strukturave të Forcës Ajrore

Gjeneral brigade Pulaj: Profesionalizmi dhe përkushtimi i grave në uniformë, aset i FA-ve

Në mjediset e Komandës së Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ylli Pulaj zhvilloi takim me përfaqësues të personelit, vajza e gra në uniformë dhe ato civile të strukturave të Forcës Ajrore në Garnizonin e Rinasit.

Gjeneral brigade Pulaj, në fjalën e tij përshëndeti ushtaraket nënforcere, oficerë dhe personelin civil të strukturave të Forcës Ajrore për kontributin e tyre duke theksuar se, në Forcën Ajrore kemi një prezencë të mirë të grave dhe vajzave ushtarake dhe civile të cilat drejtojnë edhe sektorë të rëndësishëm të strukturave të Forcës Ajrore.

Gjithashtu komandanti, ndërmjet të tjerash, përcolli mesazhin se prania dhe puna e vajzave e grave në uniformë dhe atyre civile në strukturat e Forcës Ajrore është për t'u vlerësuar, për korrektësinë dhe përkushtimin që ato tregojnë çdo ditë me profesionalizmin e tyre.

Në fund të fjalës së tij, gjeneral brigade Pulaj siguroi se, Komanda e Forcës Ajrore ka në vëmendje dhe do të vijojë të mbështesë



vajzat dhe gratë ushtarake e civile për kryerjen e detyrave me sa më shumë cilësi, për të përmbushur me sukses detyrat dhe për të çuar përpara Forcën Ajrore, si dhe u uroi shëndet në familjet e tyre.

Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg: Shqipëria eksportuese e paqes, si aleate dinjitoze në NATO

Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg takon trupat shqiptare në Letoni. Ai iu shprehu konsideratën e tij dhe të aleancës për gadishmërinë dhe përkushtimin e treguar në misione të përbashkëta. Shqipëria eksportuese e paqes, si aleate dinjitoze në NATO, do të shprehej Stoltenberg.



Aktivizohet në Shqipëri Shtabi i Përpëruar i Komandës së Forcave Speciale amerikane në Europë. Në ceremoninë e zhvilluar me këtë rast ishin të pranishëm ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, ambasadorja e SHBA-së në Shqipëri Yuri Kim, zëvendësministria Dallëndyshe Bici, gjeneralmajor David Tabor, komandant i Forcave Speciale amerikane në Europë, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Bajram Begaj, si dhe zëvendëshefja e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu.

Në fjalën e tij, ministri i Mbrojtjes, duke shprehur kënaqësinë për këtë vlerësim që i bëhet Shqipërisë, tha se: “Rëndësia dhe jehona e vendosjes së këtij shtabi i kalon ‘kufijtë’ e vendit tonë, pasi është i një rëndësie të veçantë për të gjithë rajonin”.

“Ne vlerësojmë dhe mirëpresim përpjekjet e panumërta të Shteteve të Bashkuara për sa i përket rritjes së aftësive dhe kapaciteteve ushtarake të vendeve të rajonit tonë dhe, në veçanti, mbështetjen dhe ndihmën e vazhdueshme që SHBA-të kanë dhënë për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Dislokimi i këtij shtabi në Shqipëri, është një tjetër provë e fortë e këtyre përpjekjeve”, - theksoi ministri Peleshi.

Sipas ministrit Peleshi: “Ky vendim erdhi në momentin e duhur, në kulmin e pasigurive dhe situatës së zymtë që po kalon kontinenti ynë, si dhe dëshmoi për të disatën herë lidhjen e fortë që buron nga partneriteti strategjik i Shqipërisë me SHBA-të.

Vendi ynë e ka bërë të qartë qëndrimin për sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës, sipas kufijve të saj të njohur ndërkombëtarisht. Mbështetja jonë për Ukrainën ka qenë dhe do të vijojë të jetë e palëkundur. Kjo mbështetje konsiston në qëndrime politike, diplomatike, e cila kulmon me veprimet dhe qëndrimet tona në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, por edhe mbështetje të natyrës praktike ushtarake. Për më tepër, kush mendonte se do të na përçante në këtë situatë të vështirë, bëri llogari të gabuara, pasi, Aleanca jonë, BE dhe gjithë komuniteti perëndimor u bashkuan dhe janë më të bashkuar se kurrë më parë, në mbështetje të Ukrainës”, - theksoi ministri Peleshi.

Sipas tij: “Shqipëria mbetet e angazhuar për vijimin dhe shtimin e përpjekjeve që mbajnë larg rajonit tonë këta aktorë me qëllime dhe influenca dashakeqëse”.

Ministri i Mbrojtjes tha se vendosja e këtij shtabi në vendin tonë është një sinjal i fortë për të gjithë rajonin.

Për ambasadorën amerikane Yuri Kim, prania e kësaj baze amerikane, tregon se lidhjet mes Shqipërisë dhe SHBA-ve janë më të forta se kurrë: “Vitin e kaluar mikpritët ‘Defender 21’, duke dëshmuar se marrëdhënia jonë e sigurisë ishte gati për nivelin tjetër. Dhe ja ku jemi. Me vënien në funksion të Task Forcës për Ballkanin për herë të parë në histori, Shqipëria ndoshta për habi të të gjithëve, do të jetë baza e një pranie të përhershme ushtarake amerikane”, - u shpreh ambasadorja e SHBA-ve, Yuri Kim.

Ky shtab do ofrojë ekspertizë të lartë dhe do të sigurojë ndërveprimet me Forcat Speciale shqiptare, por edhe me ato të rajonit.



SHBA aktivizon në Shqipëri Shtabin e Forcave Speciale për Europën

Ministri Peleshi: Rëndësia e vendosjes së këtij shtabi i kalon ‘kufijtë’ e vendit tonë, pasi është i një rëndësie të veçantë për të gjithë rajonin



Në Kuvend për rezolutën për mbrojtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial të Ukrainës

Ministri Peleshi: Ne jemi me Ukrainën, Ukraina sot nuk po lufton për Ukrainën, por për lirinë e të gjithëve

Në parlamentin shqiptar, një vend i rëndësishëm iu dha rezolutës së mbrojtjes për sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës, ku mes të tjerash në fjalën e tij ministri i mbrojtjes Niko Peleshi do të theksonte: “Ne jemi i vetmi vend pa probleme politike në orientimin tonë gjeopolitik, dhe kjo është meritë e të gjithëve bashkë, pa përkatësi politike kur vjen çështja tek orientimi ynë perëndimor. Ne jemi të gjithë me perëndimin, nuk ka parti politike apo organizata joqeveritare që të jenë kundër orientimit perëndimor. Jemi në kushtet ku duhet të bashkohemi pikërisht në këtë narrativë dhe jo ta dobësojmë atë, në mënyrë që të dëgjohet në Bruksel dhe aty ku duhet.

Sot është dita të flasim për Ukrainën, prandaj të tregojmë përgjegjshmëri historike, të bashkohemi në procesin e sapofilluar të rishikimit të strategjisë së sigurisë kombëtare.

Unë drejtoj një institucion shumë të rëndësishëm, sidomos në këtë kohë trazirash dhe mezi presim, me procedurë të përshpej-

tuar të miratojmë një rishikim të strategjisë kombëtare, e cila më pas të derivojë në strategji të mbrojtjes dhe rishikim të objektivave dhe kapaciteteve tona.

Natyrisht që na duhet të vëmë më shumë forca për modernizimin dhe rritjen e buxhetit për mbrojtjen. Më tej ministri Peleshi do vijonte: “Agresioni rus po e kthen historinë e botës nga një botë që po drejtohej, në dukje, nga ideale dhe vlera globale, në një botë me shumë pole. E në këtë botë në ndryshim, ne duhet të qëndrojmë shumë fort me perëndimin. Duhet

t’i themi perëndimit që jemi të gjithë bashkë, ndaj na pranoi, na integroni siç e meritojmë me procedurë të përshpejtuar dhe jo duke na bërë peng të debateve historike, gjuhësore, etnike, kulturore të papranueshme për këtë situatë.

Ne jemi me Ukrainën. Kemi qenë nga vendet e para në Europë dhe botë që i kemi dhënë ndihmë konkrete ushtarake Ukrainës dhe do të vazhdojmë ta bëjmë, sepse Ukraina sot nuk po lufton për Ukrainën, por për lirinë e të gjithëve”, -tha Peleshi.



URIMI I ZËVENDËSSHEFES SË SHTABIT TË PËRGJITHSHËM TË FA, GJENERALMAJOR MANUSHAQE SHEHU PËR 8 MARSIN

"Krenare që i kemi shërbyer me përkushtim e devotshmëri atdheut"

Për ju koleget e mia që militoni në Forcat e Armatosura!

Ky 8 mars i gjen femrat ushtarake e civile që shërbejnë në FA, në misionet paqeruajtëse jashtë vendit, në kuadër të NATO-s, OKB-së, BE-së, që nga Sudani i Jugut, Kosova, por edhe në shtabet e NATO-s e Përfaqësitë Ushtarake jashtë vendit.

Që nga nëntori i vitit 1977, Kombet e Bashkuara (UN), 8 marsin e kanë njohur botërisht si "Ditën e Gruas", ditë kur të drejtat e gruas u vunë në agjendën e ditës të politikës mbarëkombëtare, për shkak se që më 8 Mars 1857, gratë punëtore të një fabrike tekstili dhe veshjeje të Nju Jorkut – SHBA u ngritën kundër shtypjes dhe shfrytëzimit në punë për të fituar të drejtat e tyre dhe të shumë ngjarjeve të tjera të mëvonshme.

8 marsi është një ditë e shënuar edhe për gratë shqiptare, të cilat nga dita në ditë e gjejnë veten e tyre më të vlerësuar e më të ndërgjegjshme për rolin e tyre në jetë e shoqëri. Në këtë kuadër edhe gratë ushtarake ky 8 mars i gjen më optimiste për të ardhmen e tyre.

Në këtë ditë të shënuar, dëshiroj t'ju drejtohem juve, jo vetëm si zëvendësshefe e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura e si gjenerale, por si njëra prej jush, si grua, kolege, nënë e motra juaj, Gëzuar festën e Nënës, Shëndet e lumturi paçi në çdo aspekt të jetës tuaj familjare e shoqërore!

Në mënyrë të veçantë dëshiroj të përshëndes femrat ushtarake që ky 8 mars i gjen në misionet paqeruajtëse jashtë vendit, në kuadër të NATO-s, OKB-së, BE-së, që nga Sudani i Jugut, Kosova, por edhe në shtabet e NATO-s e Përfaqësitë Ushtarake e ambasadat shqiptare jashtë vendit.

Ky 8 mars, një pjesë të femrave ushtarake shqiptare i gjen në fushat e poligonet e stërvitjes, në mbështetjen e furnizimit e reparteve, i gjen pranë anijeve luftarake e pranë mjeteve ajrore, i gjen në patrullim në detyrat policore, në kryerjen e shërbimit të rojës, në auditorët e Akademisë së Forcave të Armatosura, në kurse të ndryshme të arsimimit e të kualifikimit, duke përfshirë edhe atë të pilotit, në ndjekjen e situatës në Ukrainë, me dëshirën dhe shpresën për ndërprerje sa më parë të luftës, e cila u ka marrë jetën shumë civilëve të pafajshëm, midis tyre edhe gra e fëmijë, i gjen në Shtabin e Përgjithshëm e në



shtabet e Komandave të Forcave, në strukturat e Ministrinë e Mbrojtjes, e kudo tjetër ku është nevojë dhe ku e kërkon funksioni organik, duke mos neglizhuar për asnjë çast e moment kryerjen e detyrave, të cilat gjej rastin t'i përshëndes e t'i falënderoj për përkushtimin e treguar ndaj detyrës.

Në këtë 8 mars, gjej rastin të falënderoj ministrin e Mbrojtjes z. Niko Peleshi dhe Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Prof. Asoc. Bajram Begaj, për kujdesin e mbështetjen e treguar ndaj femrave ushtarake, si në rekrutimin, promovimin dhe ecurinë e tyre në detyrë e karrierë, e cila ka bërë që sot numri

i femrave ushtarake të jetë 14.47% me objektivin për të qenë 15%.

Ky 8 mars pati një vëmendje më të veçantë nga lidërsip civil dhe ushtarak i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të FA-së. Zhvillimi pikërisht në këtë datë, i këtij aktiviteti të organizuar nga Forcat e Armatosura shqiptare dhe Zyra amerikane e Bashkëpunimit të Mbrojtjes (ODC), ku marrin pjesë ministri i Mbrojtjes z. Niko Peleshi, ambasadorja amerikane Yuri Kim, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Prof. Asoc. Bajram Begaj, komandanta e Gardës Kombëtare të New Jersey-t, gjeneral brigade Lisa Hou, si dhe mjaft gra dhe



vajza ushtarake si nga FA-të shqiptare ashtu dhe nga ato amerikane dhe me-sazhet që ata dhanë, tregon mbështetjen dhe rëndësinë që i jepet rolit të femrës ushtarake (vajzave e grave me uniformë) në Forcat e Armatosura

Sot kemi piloten e parë shqiptare femër, Armela Murati dhe femrën e parë në Truprojën e Nderit, Elona Likaj, të cilave u dërgoj një urim special në këtë ditë të shënuar të jetës së tyre.

Ashtu sikurse femrat ushtarake aktive edhe ato në rezervë, i gjen sot deputete, biznesmene, por edhe shtëpiake të papuna. 8 marsi është festë për të gjitha, prandaj në këtë ditë të shënuar një urim të veçantë dëshiroj të jap gjithë atyre ushtarakeve femra, ushtarake profesioniste, nënoficere e oficere, të cilat për arsye ligjore e kanë ndërprerë karrierën ushtarake ose që për arsye moshe kanë dalë në pension, Gëzuar festën e Nënës! Vlerësim e mirënjohje për kontributin tuaj në vite, si pjesë e Forcave të Armatosura! Krenare që i kemi shërbyer me përkushtim e devotshmëri atdheut, duke sakrifikuar jo në pak raste veten dhe familjen Tuaj! Qofshi përjetë të lumtura, si nëna e si gjyshe!

Megjithëse trajtimi dhe vlerësimi që u bëhet sot femrave, ka njohur gjithmonë përmirësim e rritje si në aspektin ligjor, ashtu edhe në zbatimin praktik, përsëri ka vend që, si gra të mos reshtim së kërkuari ndaj strukturave shtetërore, por edhe në familje ndaj bashkëshortëve tanë një trajtim më human e njerëzor.

Prandaj në këtë 8 Mars, ditë të cilën nuk duhet ta konsiderojmë vetëm si ditë feste, por edhe si ditë të manifestimit të kërkesave tona, ju bëj thirrje grave

ushtarake e patjetër edhe atyre civile: Luftoni e kontribuoni më shumë për veten tuaj! Mos pushoni së studiuar për të arritur me punë e mundim çdo ambicie profesionale e të karrierës edhe atë që konsiderohet e paarrtshme! Luftoni dhe kërkonit të gjejnë zbatim të gjitha ligjet në fuqi që u japin të drejta grave ashtu si edhe burrave! Luftoni e kërkonit që promovimi në detyrë e gradë të mos konsiderohet si "lëmoshë e mëshirë" ndaj femrave, por si një e drejtë që ju takon dhe e meritoni! Luftoni dhe kërkonit që edhe në familje të mos jeni pre e dhunës dhe e diskriminimit, siç ndodh në ndonjë rast edhe ndaj femrave ushtarake! Kurrë mos pranoni dështimin në karrierën tuaj! Edhe nëse ndodh përpikuni për të bërë të pamundurën. Dështimi juaj duhet të jetë sfidë për të tjerat!

Ambiciet tona si individë, në pozicionin e punës, por edhe në grup si gra duhet të jenë të arrijmë gjithçka që është e mundur, gjithmonë të tregojmë me aftësi e me punë se jemi në gjendje të bëjmë punë të dobishme ndaj shoqërisë dhe atdheut, aq sa edhe burrat.

Por kur këto t'i kemi arritur, të dimë t'i vëmë në zbatim e të mos zhgënjëjmë në besimin e dhënë ndaj nesh. Mos mendoni asnjëherë se si gra kemi arritur çdo gjë në mbrojtjen e të drejtave tona. 8 marsi është mbi të gjitha arritje e të pamundurës.

Gëzuar festën e Nënës!

**ZËVENDËSSHEFE E SHTABIT
TË PËRGJITHSHËM TË FA
GJENERALMAJOR
MANUSHAQE SHEHU**





PËRFUNDON 5-GARËSHI SPORTIV USHTARAK, FORCA TOKËSORE SHPALLET KAMPION

Gjeneralmajor Manushaqe Shehu: Ju jeni elita e sportistëve ushtarakë shqiptarë

Përfundon 5-garëshi sportiv ushtarak. Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, në garnizonin e Zall-Herrit, ishin të pranishëm zëvendëssefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Ferdinand Dimo, komandantë repartesh vartëse të SHPFA, FT etj.

Duke përshëndetur pjesëmarrësit në këtë eveniment sportiv, gjenerale Shehu iu shprehu atyre përgëzimet dhe urimet me të mira për organizimin e një aktiviteti të kësaj natyre: “Ju jeni elita e sportistëve ushtarakë shqiptarë. Gjatë gjithë 5-garëshit, ju treguat vlerat dhe aftësitë më të mira fizike që zotëroni. Ju sfiduat njëri-tjetrin në këto gara, duke dhënë maksimumin tuaj. 5-garëshi ushtarak nuk është thjesht një garë sportive, por shumë më tepër se kaq. Nëpërmjet tij, ju treguat jo vetëm vlerat tuaja individuale dhe shpirtin e garës, por mbi të gjitha respektin reciprok për njëri-tjetrin, duke thelluar edhe më tej miqësinë dhe vëllazërinë, që na karakterizon ne si ushtarakë. Më lejoni që të përcjell tek të gjithë ju, dhe në veçanti për fituesit e këtij kompeticioni, urimet më të mira edhe në emër të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm dhe Ministrisë të Mbrojtjes”, - u shpreh ndër të tjera zëvendëssefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjener-



almajor Manushaqe Shehu.

Nga zhvillimi i këtij aktiviteti sportiv tashmë janë përzgjedhur edhe efektivet që do të marrin pjesë

në aktivitetin “Best Soldier 2022, në Kosovë dhe në Kroaci”.

Ceremonia, vijoi me ndarjen e çmimeve për fituesit e aktivitetit sportiv.

Këto gara sportive edhe këtë vit u dominuan nga Forca Tokësore, përfaqësuesit e së cilës zunë vendin e parë si ekip, por edhe si individ. Në përfundim

të tij u arritën këto rezultate:

Renditja si ekip:

Vendi i I: Forca Tokësore

Vendi i II: Akademia e Forcave të Armatosura

Vendi i III: Komanda e Forcës Detare

Renditja si individ:

Vendi i I: ushtar III Ilmi Mala (Forca Tokësore)

Vendi i II: rreshter Vladimir Haxhija (Forca Tokësore)

Vendi i III: ushtar Griseld Hidri (Forca Tokësore)

5-garëshi ushtarak, është një aktivitet i përvitshëm sportiv i cili gjen të angazhuar në të, ekipe nga të gjithë Forcat dhe repartet autonome të SHPFA. Ky aktivitet, i cili karakterizohet gjithmonë nga rivaliteti dhe shpirti i garës, synon që të rrisë nivelin e përgatitjes fizike të ushtarakëve shqiptarë, por edhe të forcojë ndjenjën e miqësisë dhe respektit të ndërsjellë.

OBJEKTIVAT

Zbuluesit e Regjimentit të Operacioneve Speciale përfundojnë stërvitjen dimërore

Kompania e Zbulimit e Regjimentit të Operacioneve Speciale (ROS), i Forcës Tokësore (FT), zhvilloi stërvitjen fushore dimërore 72-orëshe.

Trajnimi i zhvilluar në rajonin e Bizës, kishte për synim testimin e kapaciteteve të kompanisë së Zbulimit mbi planëzimin, organizimin dhe zhvillimin e operacioneve HUMINT, në kushte ekstreme moti dhe terreni, me dislokim të plotë në nivel kompanie.

Objektiva kryesore, të realizuar gjatë periudhës stërvitore ishin: kompaktësimi i veprimeve në nivel grupi, skuadre, toge; përgatitja e urdhrave sipas niveleve; kryerja e intervistave taktike me popullsinë lokale në zonën e operacionit etj.

Ndërkohë që skenarët e ushtrimeve stërvitore, parashikonin aplikimin e temave të ndryshme si: zbulim në qendrat e banuara, patrullim, marrje kontakti me qëllim mbledhjen e informacioneve etj.

Stërvitja dimërore, e zhvilluar në kushte të vështira të terrenit dhe motit me dëborë, shërbeu për rritjen aftësive profesionale të trupave të Kompanisë së Zbulimit, si nënrepart me rëndësi të veçantë i Regjimentit të Operacioneve Speciale.



INTERVISTA

47 VJET IGJIU

**Ish-drejtori i institutit të Topografisë Ushtarake (kolonel),
i laureuar me titullin “Mjeshtër Kërkimesh”, z. Myslim Pasha**

Sistemi gjeodezik i standardeve të NATO-s, realitet krenarie

Intervistoi:
Shefe e Sektorit të Botimeve,
ANJEZA MUSOLLARI

Shqipëria ka një datë me shumë domethënie në historinë e saj, ndoshta që prej Pavarësisë. Dhe kjo ka të bëjë me gjeodezinë, krijimin e këtij institucioni kaq të rëndësishëm.

Instituti do të hartonte politika të grumbullimit, përpunimit, mirë-administrimit të informacioneve gjeografike dhe të gjeosistemeve në shkallë vendi. Ai organizonte përgatitjen topogjeodezike të terrenit shqiptar, përgatitjen e literaturës topografike e gjeografike ushtarake për armët dhe shërbimet e ushtrisë, do të planifikonte të gjithë punën për përgatitjen topografike të kuadrove dhe efektivëve të strukturave të forcave të armatosura, për planëzimin dhe krijimin e rezervave të nevojshme me harta topografike dhe tematike apo speciale, si dhe do të ideonte dhe organizonte punën studimore, shkencore në fushat përkatëse..

Në një intervistë për gazetën “Ushtria” ish-drejtori i institutit të Topografisë Ushtarake (kolonel), profesor me gradën shkencore “kandidat i shkencave”, i laureuar me titullin “Mjeshtër Kërkimesh”, z. Myslim Pasha, në 47-vjetorin e krijimit të këtij instituti do të na sillte një panoramë të plotë të aktivitetit të tij.

Përvjetorët festivë të institucioneve ushtarake janë ngjarje jo vetëm për efektivët e tyre por edhe për të gjithë Forcat e Armatosura. Në këtë kuadër është edhe ditë-krijimi i IGJIU-së

Është festa e përbashkët e topografëve, gjeodetëve dhe gjeografëve të Ushtrisë Shqiptare (Forcave të Armatosura në vit). Është festa e hartës e pikturës së portretit hartografik të Shqipërisë, festa e koordinatave lartësive dhe thellësive të trajtave të këtij vendi, e modelit të ndryshimeve në kujtesën dhe gjeo-historinë e kombit tonë, festa e Projeksonit të mbijetesës dhe zhvillimit të territorit.



limeve të së ardhmes.

Mbetet një ngjarje që nuk sjell
thjesht një datë të zakonshme. Të
zgjohet kujtesa me një hartë Shqipë-
rie në dorë, krah çeljes së luleve,
me një hartë të përtërirë, të ardhur
prej mbijetesës kombëtare, gjer në
ditë të sotme. Me këtë hartë shohim
portretin e mbijetesës, ndihmesat e
breznive, për të vizatuar e piktu-
ruar tiparet e këtij Dheu dhe Deti.
shtrirjen historike, në projeksionet
e padrejtësive, kufijtë e prerë prej
tragjedisë dhe me ndryshimet që
u bënë përmbi këtë portret. Është
djepi hartografik që na përkund.

Shërbimi Hartografik dhe Gjeodezik në FA, ka një zanafillë që vjen që nga lashtësia, apo jo?

Hartat e botës që nga shekulli IV p. e. r. ato të Herodotit, Hekatu-Eratostenit, Strabonit dhe Ptolemeut, bartin në vete dhe trajtat e Ilirisë së hershme dhe vendpozicionimin e Ilirëve. Historia që vjen e hartë të tilla portret me qendresë që

komunist që u vendos, kur Bashkimi Sovjetik u shtri si një Perandori Komuniste. Hartat gjatë kësaj periudhe sollën standarde të reja, ku për herë të parë morën pjesë edhe hartografët dhe gjeodetët e parë të Shqipërisë. Më 2 prill 1946 fillon organizimi i Shërbimit Gjeodezik të Ushtrisë Popullore. Ndërkaq në vitin 1953 filloi veprimtarinë edhe Dega e Topografisë në Shtabin e Përgjithshëm. Më vonë krijohet dhe vepron Detashmenti Autonom Topografik i Shtabit të Përgjithshëm, që kreu disa detyra të rëndësishme gjeotopografike.

Kur u krijua Instituti Topografik i Ushtrisë?

Me vendim të Këshillit të Ministrave në datën 8.05.1975 krijohet Instituti Topografik i Ushtrisë (ITU). Ai kishte detyrë dhe mision kombëtar që të hartografonte Republikën e Shqipërisë në shkallë të mesme dhe të vogël, me vlera në fushën e Mbrojtjes së vendit dhe të zhvillimit ekonomik shoqëror e kulturor të Shqipërisë. Ai do të kishte si detyrë bazë nga ana studimore të ndërtonte Rrjetin Gjeodezik Shtetëror si dhe do të kishte edhe monopolin e Fotografimit Ajror. Kjo

i shërben vetëm ushtrisë por gjithë spektrit zhvillimor shqiptar.

itet shtatëdhjetë të shekullit
që shkoi ishin të ngërthyer me një
situatë politike dhe ideologjike nga
më dramatiket në Shqipëri

Ishte një tronditje e madhe jo vetëm për Ushtrinë por edhe për gjithë vendin. Beqir Balluku ishte shpallur armik. Pas tij gjeneralë të njohur shqiptarë që kishin ardhur nga Lufta e Dytë Botërore, shkollin pas njëri-tjetrit, si në gijotinë (Petrit Dume, Hito ako) dhe shumë të tjerë. Si një shkullmë e fortë shkallmuese frynte era e të ashtuquajturave “Teza të eza” dhe komplete pas saj. Pikërisht në këtë kohë tronditëse, profesionistë të topografisë ushtarake, nuk ndiqnin politikën e kohës as ideologjinë, ata iu përveshën punës që të krijonin një Institut për t i shërbyer hartografimit dhe gjeodezisë kombëtare. Pra, në këtë eveniment nuk ka asnjë ndikim ideologjik. Ishte koha që gjeodezia dhe hartografia shqiptare të krijonte profilin e saj, t i shërbente zhvillimit. Ata që e krijuan këtë Institut nuk u nisën vetëm nga ndërmarrja fantazmë e

● Mbetet një ngjarje që nuk sjell thjesht një datë të zakonshme. Të zgjohet kujtesa me një hartë Shqipërie në dorë, krah çeljes së luleve, me një hartë të përtërirë, të ardhur prej mbijetesës kombëtare, gjer në ditë të sotme. Me këtë hartë shohim portretin e mbijetesës, ndihmesat e breznive, për të vizatuar e pikturuar tiparet e këtij Dheu dhe Deti, shtrirjen historike, në projeksionet e padrejtësive, kufijtë e prerë prej tragjedisë dhe me ndryshimet që u bënë përmbi këtë portret. Është djepi hartografik që na përkund.


të njohur të Ilirëve në hartat Romake, Arabe, Portulane, ndër hartat e Periudhës së Re, kur kontributet hartografike dhe gjeodezike erdhën nga pushtuesit, ndaj kemi gjurmët e Institutit Gjeografik të Vjenës, Institutit Gjeografik Ushtarak të Firences që realizuan studimet dhe hartat e para topografike. Në Periudhën pas Luftës së Dytë Botërore, sërish në fatin e ndikimeve të sistemit

nuk është thjeshtë një histori. Është një ngjarje që nuk sjell vetëm një datë të thjeshtë të një instituti të zakonshëm. Kjo ngjarje sjell në histori një nga institutet më në zë të fushës studimore dhe krijuese në Shqipëri, sepse ky institut është marrë dhe merret me Hartën e Shqipërisë, me portretin e saj në kohë dhe hapësirë, me gjeohistorinë e këtij vendi që nuk

bunkerizimit të Shqipërisë, por për nevojat gjithësore që kishte vendi në të gjithë fushat.

Kush ishin nismëtarët e tij të parë?

Ideatorët kryesorë që duhet t'i përmendë historia janë Dhimo Dhaskali, Limos Alimuçi, Vait Tartari, esk Begu, Thimi organ hi, Myslim Ha hiu, Filip Marga, Mulla



Mullaj, të cilët ishin ndër kryesorët që punuan në këtë projekt të ri që do t'i vlente ardhmërisë së këtij shërbimi. Po nuk mund të harrohen edhe shumë të tjerë që punonin në sektorët e krijuar dhe dhanë mendime të çmuara. Ky Institut do të ishte institucion ushtarak kërkimor dhe prodhues, në fushën e përgatitjes topografike të ushtrisë shqiptare dhe më gjerë. Më 15 mars 1975, u caktuan drejtori dhe zëvendësdrejtori: Limos Alimuçi dhe Vait Tartari. Pas tyre vinte një bashkësi kuadrosh oficerë të shkallëve dhe të breznive të ndryshme të cilët kanë lënë jetën e tyre në vlera të mëdha hartografike dhe vepra që s'harrohen si: Perlat Gjolliku, Robert Hajro, Kleanthi Dhimitri, Çarçan Danaj, Novrus Xhaferi, Xhavit Xhani, Gani Mustafa, Vangjel Gaçe, Niko Zheku, Benjamin Lohja, Agim Mezini, Seit Shapllo, Hasan Dyli, Zeqo Zano, Bilbil Mehmeti, Hysen Dervishi, Liliana Duri, Marjeta Pasko e të tjerë. Më pas vjen një brez i tjetër kuadrosh që mbaruan shkollat ushtarake brenda vendit dhe u arsimuan edhe në Univeristet e Tiranës, Përparim Likaj, Maksimilian Gjika, Eduart Isufi, Stefan Shahini, Asllan Muka, Piro Dado, Bajram Muja, Ptoleme Biku, Asllan Bebeçi, Kostandin Premti e shumë të tjerë që mbushën kontributet teknike e kërkimore në fushat inxhinierike. Po kështu një bashkësi e tërë kuadrosh topografë nga shkollat ushtarake zunë pozicione të rëndësishme në Institut si në Astronomi, Gjeodezi, Hartografi si Asllan Gorezi. Llukan Mici,

Vladimir Koruni, Asim Beja, Josif Kollçi, Mustaf Koçerri, Kujtim Ago. Një brezni e më këndejme do të vinte me Çelik Muratin, Behar Malaj, Bashkim Çapunin, Faik Teki Meta, Osman Tome.

Misioni hartografik dhe gjeodezik i IGJU-së është mision kombëtar. A mund të na shpjegojë diçka më tepër?

Kujtuam pak më parë atë që quhet: "Mision", që nuk lidhet për gryke nga politika dhe ideologjia. Është ana shkencore dhe teknike që ka themel. Nëse ka diçka që duhet t'u thuhet me lavde breznisë që shkoi dhe që ndërtoi ITU, është se ata panë në rrënjë "Misionin topografik dhe gjeodezik" dhe për këtë do të ngelen në histori.



Breznia që erdhi e gjeti këtë udhë të hapur. Kjo duhet thënë me plot gojë. Rrallë mund të ketë ndodhur që në kushte të izolimit komunist të ndërtoheshin vepra aq të mëdha kombëtare se sa rrjeti Gjeodezik Shtetëror, se sa hartografimi në të gjithë shkallët (1: 10 000, 1: 25 000, 1: 50 000 deri në 1: 1000 000), vepra të vlerësuara nga ana shkencore dhe teknike gjer në ditë të sotme. Ka qenë një energji e jashtëzakonshme. Pa këtë bazë nuk do të kish arritur kulme dhe nuk do të kish pasur një Institut Gjeografik Ushtarak, i cili të përballëj me kërkesa të reja të zhvillimeve postkomuniste. Është një periudhë e gjatë, e trazuar, me zigzage të cilat kulmuan në vitin '97, kur ky institut u gjend në prag të shfarosjes dhe djegies makabre. Por u arrit që të shpëtohej, ndërkaq ishte në pikëpyetje e ardhmja e tij.

Projekte të mëdha me natyrë kombëtare janë realizuar. A mund të shtjelloni disa prej tyre?

Nuk është e lehtë që të jesh në hullinë e informacioneve moderne si dhe të teknologjive. Mos harroni se Shqipëria të gjithë projektet zhvillimore të saj i ka bërë dhe po i bën në bazë të hartografimit dhe të gjeodezisë themelore që ka kryer ky institut. Nuk është pak të shndërrosh sistemin gjeodezik, të kalosh në harta të standardeve të NATO-s, në Sistemin e Pozicionimit Global të bashkëpunimit me institucione të huaja. Këto janë vlera që janë pranuar nga partnerët ndërkombëtarë. Ky është një realitet krenarie, sigurisht.

Ju folët për "mision hartografik kombëtar". A është cenuar ndonjëherë?

Misioni që ka Instituti lidhet

me Informacionet hapësinore, e këtu buron ai kujdes inteligjent që duhet qysh në krye të veprave dhe Projekteve. Mbase është dhimbje, por edhe ajo duhet cekur, gjithsesi. Nuk mund të harrohet asnjëherë Marrëveshja e De-limitimit të Detit midis Greqisë dhe Shqipërisë në vitin 2009! Ajo që ndodhi është dramatike. Kjo ka lidhje me atë se a është në gjendje IGJIU për menaxhimin hapësinor hartografik të kufijve shtetërorë të Republikës?

Ndryshimet që ndodhën pas viteve '90, u reflektuan në misionin e Institutit?

Tani Instituti quhet: "Institut Gjeografik dhe Infrastrukturës". Kërkohet një realitet dhe angazhim tërësor në zhvillimet e sotme në rajon dhe më gjerë, në situatat gjeopolitike që mund të vijnë, ku gjeografia luan rolin e saj të madh vetëm atëherë kur rojat hartografike kombëtare janë në krye të orientimeve zhvillimore të reformave të sotme jo vetëm në FA por edhe për gjithë vendin. Udhë e mirë e përtëritjes së hartave 1: 25 000 sipas standardeve të NATO-s dhe një projekt Detar me Norvegjinë, rrëfen se këto koordinata orientuese janë frymëzuese. Në histori dhe në përvojë, Lufta e Kosovës ishte në kreun e ndihmesës së madhe hartografike dhe gjeodezike në studimin e hapësirës së Republikës së Kosovës. Projekti i parë që u krye me NIMA (National Imagery and Mapping Agency) e SHBA-së, përtëritja e hartave topografike të shkallës 1:50 000 sipas standardeve të NATO-s. Pikërisht nga ky projekt filluan edhe ndryshimet e mëdha në Institut. Me një vendim të posaçëm të KM dhe ligji për Institutin prej Parlamentit të Shqipërisë, u bënë ndryshime me rëndësi në Misionin. Instituti u quajt "Institut Gjeografik Ushtarak i Shqipërisë".

A ka diçka aktuale që duhet kujtuar në këtë ditë hartografike?

Jo vetëm unë por të gjithë kolegët kuadro ushtarakë të IGJIU-së, punonjësit civilë gjithashtu, kanë se çfarë të kujtojnë edhe në situatën ndërkombëtare. Një pushtim tragjik kryhet këto ditë nga Federata e Rusisë ndaj Ukrainës. Janë hapësira, vepra urbane, qytete që pushtohen. Përpara se të kryhej ky akt është përtërirë harta topografike, është studiuar hapësira tokësore detare dhe ajrore, me sisteme koordinatash që përdoren nga të dy palët. Kjo na sjell në mendim, se sa vlerë kanë studimet e IGJIU-së për ta ushqyer Shtabin e Përgjithshëm me harta dhe koordinata, dhe informacione të tjera që i duhen veprimeve luftarake.

MSC. MIMOZA GOLIKJA

LUFTA E RUSISË NË UKRAINË, NATO QËNDRON E BASHKUAR

Aleanca, plotësisht të përkushtuar ndaj Nenit 5

NATO ka në Europë 130 avionë në gatishmëri të lartë



Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s u takua me Presidentin Egils Levits në Riga, më 8 mars 2022, në fillim të një vizite në Letoni. Ata diskutuan pushtimin brutal të Ukrainës nga Rusia, ndikimin e saj humanitar dhe implikimet për sigurinë euroatlantike.

“Kjo është rritja më e shpejtë e krizës së refugjatëve në Europë, që nga Lufta e Dytë Botërore”, -tha Sekretari i Përgjithshëm. Ai vuri në dukje raportet e besueshme të civilëve që viheshin nën zjarr gjatë evakuimit dhe nënvizoi se shënjestrimi i civilëve është një krim lufte. “Ne kemi nevojë për korridore të vërteta humanitare që respektohen plotësisht”, -tha ai. Sekretari i Përgjithshëm vlerësoi gjithashtu aleatët për mbështetjen e Ukrainës, imponimin e kostove ndaj Rusisë dhe forcimin e pranisë së NATO-s në lindje, duke dërguar një mesazh të qartë se NATO do të sigurojë dhe mbrojë çdo centimetër të territorit aleat.

Sekretari i Përgjithshëm vizitoi gjithashtu grupin e betejës shumëkombëshe të NATO-s të udhëhequr nga Kanadaja në kampin Adazi, së bashku me kryeministrin letonez Krišjānis Kariņš, kryeministrin kanadez Justin Trudeau dhe presidentin spanjoll Pedro Sánchez. Ata u takuan me trupat e NATO-s që shërbenin në grupin e betejës, ku Sekretari i Përgjithshëm i vlerësoi ata për shërbimin e tyre. Ai falënderoi gjithashtu aleatët, përfshirë Kanadanë, Spanjën dhe Shtetet e Bashkuara, për dislokimin e qindra trupave të tjera në grupin e betejës. “Prania jonë këtu në Letoni dërgon një mesazh të pagabueshëm uniteti dhe vendosmërie: angazhimi ynë ndaj nenit 5 të Traktatit të Uashingtonit është absolut”, -tha ai.

NATO ka në Europë 130 avionë në gatishmëri të lartë, mbi 200 anije nga Veriu i Lartë në Mesdhe dhe mijëra trupa shtesë në rajon

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s informoi lidhur me takimin dhe diskutimet që zhvilluan me Presidentin e Letonisë, Egils Levits, në një konferencë të përbashkët për shtypin. “Ne sapo patëm një diskutim të rëndësishëm për pushtimin brutal të Ukrainës nga Rusia dhe implikimet për sigurinë tonë. Populli ukrainas dhe forcat e armatosura kanë frymëzuar botën me guximin e tyre, por sulmi i Presidentit Putin vazhdon dhe ndikimi humanitar është shkatërrues”, -tha Sekretari i Përgjithshëm. Ai tha se shumë civilë janë vrarë ose plagosur dhe 2 milionë njerëz kanë ikur nga Ukraina dhe se kjo është kriza me rritjen më të shpejtë të refugjatëve në Europë që nga Lufta e Dytë Botërore. “Ka raporte shumë të besueshme për civilët që janë vënë nën zjarr ndërsa përpiqen të evakohen. Sulmi ndaj civilëve është një krim lufte dhe është krejtësisht e papranueshme. Ne kemi nevojë për korridore të vërteta humanitare që respektohen plotësisht”, -tha Stoltenberg. “Ne e bëmë të qartë për muajt të tërë se presidenti Putin do të paguante një çmim të lartë për ripërtëritjen e agresionit kundër Ukrainës dhe ky çmim është pikërisht ai që ai po paguan tani. Rusia është goditur me sanksione të rënda dhe të paprecedentë dhe izolim pothuajse total në skenën botërore”. Shefi i NATO-s tha se: “aleatët po ndihmojnë Ukrainën të ruajë të drejtën e saj themelore për vetëmbrojtje, duke rritur mbështetjen me miliarda euro dhe hapjen e kufijve të tyre dhe ofrimin e ndihmës për refugjatët, por vuajtjet që shohim tani në Ukrainë janë të tmerrshme dhe ato na prekin të gjithëve”.

“Ne kemi një përgjegjësi për të siguruar që konflikti të mos përshkallëzohet dhe të mos përhapet përtej Ukrainës. Kjo do të ishte edhe më e rrezikshme, shkatërruese dhe akoma më vdekjeprurëse dhe situata mund të dalë jashtë kontrollit”, -nënvizoi Stoltenberg. “Për t’u siguruar që nuk ka vend për llogaritje të gabuara në Moskë, NATO ka forcuar ndjeshëm pranimin e saj në pjesën lindore të Aleancës. Kemi 130 avionë në gatishmëri të lartë, mbi 200

anije nga Veriu i Lartë në Mesdhe dhe mijëra trupa shtesë në rajon, përfshirë grupin e betejës shumëkombëshe të NATO-s në Adazi”, -tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s. “Aleatët, përfshirë Kanadanë, SHBA-të dhe Spanjën, po vendosin qindra trupa shtesë këtu”, -tha ai dhe “ne do të sigurojmë dhe mbrojmë çdo pëlëmbë të Letonisë dhe çdo centimetër të të gjithë territorit aleat, Amerika e Veriut dhe Europa së bashku, duke qëndruar të fortë në NATO, aleancën më të fortë në histori. NATO qëndron e bashkuar në këtë moment kritik për sigurinë tonë të përbashkët”, -theksoi Stoltenberg. Ai tha se aleatët e NATO-s i ofrojnë mbështetje Ukrainës në mënyra të ndryshme. Aleatët ofrojnë mbështetje ushtarake për të ndihmuar Ukrainën të ruajë të drejtën për vetëmbrojtje. Aleatët e kanë bërë këtë për shumë vite.

Lidhur me situatën e sigurisë në Balltik dhe përballien reale me kërcënimin rus në zonë, Presidenti i Letonisë Egils Levits deklaroi në konferencën për shtyp se jemi të sigurt e të mbrojtur. “Ne jemi një vend anëtar i NATO-s dhe aleatët e tjerë do të na qëndrojnë pranë dhe do të na mbrojnë. NATO mbron secilin nga shtetet e saj anëtare, çdo centimetër të territorit të shteteve anëtare, përfshirë natyrisht Letoninë”, -tha ai dhe theksoi se “kishin diskutuar masat me Sekretarin e Përgjithshëm, të cilat përfshijnë masa të ndryshme praktike për t’i treguar Moskës dhe Kremlinit se NATO është e përgatitur të mbrojë territorin e saj, të gjitha territoret e saj të shteteve anëtare, duke përfshirë një sulm mbi Letoni”.

NATO thekson nga kampi “Adazi” i Letonisë, se angazhimi ndaj nenit 5 është absolut

Sekretari i Përgjithshëm në Letoni vizitoi gjithashtu grupin e betejës shumëkombëshe të NATO-s, të udhëhequr nga Kanadaja në kampin “Adazi”, në Letoni, së bashku me kryeministrin letonez Krišjānis Kariņš, kryeministrin kanadez Justin Trudeau, presidentin spanjoll Pedro Sánchez dhe ministrin e Mbrojtjes së Kanadasë, Anita Anand. Ata u takuan me trupat e NATO-s që shërbenin në grupin e betejës, ku Sekretari i Përgjithshëm i vlerësoi për shërbimin e tyre. Ai falënderoi gjithashtu aleatët, përfshirë Kanadanë, Spanjën dhe

Shtetet e Bashkuara, për dislokimin e qindra trupave të tjera në grupin e betejës në konferencën që dhanë së bashku për shtypin. “Është e mrekullueshme të jemi bashkë me të gjithë ju këtu sot”, -tha Sekretari i Përgjithshëm. “Kjo tregon vërtet solidaritetin e NATO-s që ne qëndrojmë së bashku, përballë një momenti kritik për sigurinë tonë të shkaktuar nga pushtimi brutal i Rusisë në një vend paqësor në Europë, Ukrainën. Lufta e Presidentit Putin kundër Ukrainës ka shkatërruar paqen në Europë. Ajo ka tronditur rendin ndërkombëtar dhe vazhdon të ketë një taksë shkatërruese për popullin ukrainas. Por Putini e nënvlerësoi seriozisht Ukrainën dhe ai e nënvlerësoi seriozisht forcën dhe unitetin e NATO-s, dhe të miqve dhe partnerëve tanë në mbarë botën”, -tha ai dhe përsëriti se, NATO i ka imponuar Rusisë kosto të paprecedentë. “Ne kemi rritur mbështetjen tonë për Ukrainën, duke ndihmuar në ruajtjen e të drejtës së saj për vetëmbrojtje dhe ne kemi zbatuar përf forcime historike të mbrojtjes kolektive të NATO-s”, -dhe shtoi se, “me mijëra trupa të tjera përforcojnë pjesën lindore të Aleancës sonë. Përfshirë këtu në Letoni”.

“Unë e mirëpres fuqimisht që aleatët, përfshirë Kanadanë, Spanjën dhe Shtetet e Bashkuara, po vendosin qindra trupa të tjera në pranimin tonë shumëkombëshe këtu në bazën “Adazi” në Letoni”, dhe falënderoi udhëheqjen e këtyre vendeve dhe përkushtimin e tyre për sigurinë kolektive. Kanadaja ka udhëhequr grupin luftarak të NATO-s në Letoni për vite me radhë, me aftësi dhe përkushtim. Një demonstrim i fuqishëm i përkushtimit tuaj ndaj sigurisë transatlantike. Spanja po udhëheq me shembull, duke vendosur trupa, anije dhe avionë shtesë për të forcuar pozicionin tonë mbrojtës në Europë. shte vërtet një ndër që takova forcat tuaja këtu sot, nga të dy anët e Atlantikut. Ata përfaqësojnë shpirtin e të gjithë aleatëve tanë: Të gjithë për një, dhe një për të gjithë. NATO është një Aleancë mbrojtëse. Ne nuk kërkojmë konflikt me Rusinë. Përgjegjësia jonë përfundimtare është të mbajmë të sigurt një miliard qytetarët tanë. Kjo do të thotë se, ne duhet të bëjmë gjithçka që është e mundur për të parandaluar përhapjen e konfliktit përtej Ukrainës dhe prania jonë këtu në Letoni dërgon një mesazh

të pagabueshëm uniteti dhe vendosmërie. Angazhimi ynë ndaj nenit 5 të Traktatit të Uashingtonit është absolut dhe ne do të bëjmë gjithçka që duhet për të siguruar që mbështetjen e të gjithë aleatët. Në këtë moment të rrezikshëm për sigurinë tonë, ne qëndrojmë të bashkuar për popullin dhe vlerat tona. Europa dhe Amerika e Veriut së bashku, në NATO”, -tha Jens Stoltenberg.

Kryeministri kanadez Justin Trudeau tha se vendi i tij do të vazhdonte të dërgonte armë në Ukrainë. “Ne e kuptojmë urgjencën që paraqitet tani në botë, me qëndrimin e fortë të Ukrainës kundër këtij pushtimi ilegal rus dhe kjo është arsyeja pse ne kemi dërguar ndihma, kemi dërguar armë dhe do të vazhdojmë t’u dërgojmë mbështetje ukrainasve, pasi qëndresa e tyre nuk mbron vetëm Ukrainën por ata mbrojnë demokracinë, mbrojnë vlerat që mbështesin demokracinë dhe në fakt, na mbrojnë të gjithëve”, -tha ai. “Këto armë janë shumë më të dobishme tani dhe në javët e ardhshme, në duart e ushtarëve ukrainas që luftojnë për jetën e tyre, se sa në duart e kanadezëve, por sigurisht që ne duhet të sigurohemi që t’i zëvendësojmë ato armë me shpejtësi dhe që të vazhdojmë të investojmë në pajisjet që i bëjnë forcat tona të armatosura të jenë në gjendje të vazhdojnë të kontribuojnë kudo në botë”, -tha ai dhe theksoi qasjen e Kanadasë për të vazhduar investimin në mbrojtje dhe për të investuar më shumë në mbështetjen ndaj NATO-s. “Ne duhet të mbrojmë demokracinë, duhet të jemi kudo ku duhet mbrojtur demokracia, por ne duhet t’i ofrojmë ndihmë urgjente Ukrainës, aktualisht në formën e armëve. Është e rëndësishme, jo vetëm për mbrojtjen e Ukrainës, por edhe për mbrojtjen e demokracisë në mbarë botën”, -theksoi ai.

Lidhur me pranimin në Letoni ministria e Mbrojtjes kanadeze, Anita Anand tha gjithashtu se mbrojtja është shumë e rëndësishme. “Është nënshkruar një kontratë gjashtëqind milionëshe për të garantuar sigurinë e Arktikut”, -tha ajo, -gjithashtu kemi kontaktuar me partnerët tanë në SHBA për të rënë dakord për mbrojtjen e përbashkët të kontinentit tonë dhe se si ta mbrojmë botën tonë së bashku. Modernizimi i ndihmës së Veriut është programi, i cili është absolutisht vendimtar për Kanadanë dhe një nga pri-

oritetet kryesore për qeverinë kanadeze”.

Kryeministri i Spanjës, Pedro Sanchez, nga ana e tij tha se: “është vendimtare të jemi të bashkuar, dhe këtë po tregojmë duke qenë së bashku këtu. Sanksionet ekonomike janë një nga mjetet, instrumentet më të fuqishme që kemi, për të ndaluar këtë luftë të tmerrshme dhe të pajustifikuar që Putini po bën kundër një vendi të lirë, siç është Ukraina. Është shumë e rëndësishme të veprohet në lidhje me ndikimin ekonomik në Spanjë dhe natyrisht në ekonominë botërore dhe veçanërisht në atë evropiane”, -tha ai dhe theksoi se është e rëndësishme të veprohet në dimensione të ndryshme, shumëpalëshe në nivel evropian. Ndërsa lidhur me vendimin për rritjen e numrit të trupave në Letoni, kryeministri i Spanjës, tha se Spanja ka qenë e angazhuar në Letoni për një kohë të gjatë nën komandën e ushtrisë kanadeze, por ajo do të vendosë 150 ushtarë të rinj në këtë bazë, sa më shpejt që të jetë e mundur.

“Ne jemi këtu për të penguar çdo sulm ndaj çdo vendi aleat të NATO-s dhe parandalimi ka ndihmuar në ruajtjen e paqes për më shumë se 70 vjet”, -theksoi edhe njëherë Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, duke iu përgjigjur gazetarëve lidhur me rritjen e pranisë në Letoni dhe ai tha se kjo rritje ishte për t’i dërguar një mesazh edhe më të fortë Presidentit Putin, se një sulm ndaj një aleati do të shkaktojë përgjigjen nga e gjithë Aleanca. Pra, ne jemi këtu për të mbrojtur çdo centimetër të territorit aleat të Letonisë dhe të gjitha vendeve të tjera të NATO-s”. “Qëllimi i parandalimit, -tha ai, -nuk është të provokojë luftën, por të parandalojë luftën dhe të ruajë paqen. Kur shohim veprimet agresive të Presidentit Putin kundër Ukrainës, kjo ka çuar në një përf forcim të madh të pranisë sonë në Letoni dhe gjithashtu në pjesë të tjera të krahut lindor të aleancës sonë. Dhe unë do të doja të përgëzoja Kanadanë, Spanjën dhe gjithashtu Letoninë si një vend pritës për demonstrimin e vërtetë të unitetit, duke demonstruar përkushtim ndaj mbrojtjes sonë kolektive. Për sa kohë që qëndrojmë së bashku, Amerika e Veriut dhe Europa në NATO, ne jemi të gjithë të sigurt, sepse jemi aleanca më e fortë në histori. Uniteti është shumë më i fortë sesa priste Presidenti Putin. Ai do më pak NATO, po merr më shumë NATO. Ai donte të na përçante, po merr një Aleancë më të bashkuar. Ne jemi këtu për të ruajtur paqen, për të parandaluar luftën dhe kjo është arsyeja pse ne po rrisim pranimin tonë të parandalimit mbrojtës në Letoni dhe në pjesën tjetër të pjesës lindore të Aleancës”, tha ai.

“Vladimir Putin bëri një llogaritje të gabuar thelbësore”, -do të shtonte kryeministri kanadez Trudeau në konferencën e përbashkët për shtyp. “Ai Putin mendonte se Ukraina ishte e dobët dhe ai mendonte se NATO ishte e ndarë. Është treguar se sa gabim e ka. Ukraina-sit janë të fortë dhe të guximshëm dhe janë në këmbë për të mbrojtur tokën e tyre dhe NATO nuk ka qenë kurrë më e bashkuar dhe më e vendosur se ne tani. E di që mund të flas për të gjithë anëtarët e NATO-s kur them: ne të gjithë do t’i përmbahemi nenit të pestë. Ne jemi plotësisht të përkushtuar ndaj Nenit Pesë.”

“NATO ka përgjegjësinë të sigurojë që konflikti të mos përshkallëzohet përtej Ukrainës”

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s mirëpret rolin udhëheqës të Kanadasë në përgjigjen ndaj pushtimit rus të Ukrainës

Më 9 mars 2022, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg foli në Konferencën e Otavës për Sigurinë dhe Mbrojtjen, organizuar nga Konferenca e Shoqatave të Mbrojtjes, CDA. Sekretari i Përgjithshëm theksoi mbështetjen e vazhdueshme të Kanadasë për Ukrainën. “Për shumë vite, ju keni ndihmuar në forcimin e forcave dhe institucioneve të armatosura të Ukrainës, duke përfshirë trajnimin për dhjetëra mijëra trupa ukrainase, shumë prej të cilëve janë sot në vijën e frontit. Ju gjithashtu i keni ofruar Ukrainës qindra miliona dollarë mbështetje dhe pajisje thelbësore. Të gjithë jemi të frymëzuar nga mënyra se si forcat ukrainase po i rezistojnë me guxim pushtimit rus; dhe mbështetja e Kanadasë ka ndihmuar për ta bërë këtë të mundur”, -tha ai.

“Kanadaja po jep gjithashtu një kontribut të rëndësishëm në forcimin më të madh të mbrojtjes sonë kolektive që nga fundi i Luftës së Ftohtë”, -shtoi Sekretari i Përgjithshëm. “Dje isha me kryeministrin Trudeau dhe ministrin e Mbrojtjes Anand në Letoni, ku Kanadaja ka udhëhequr grupin e betejës shumëkombëshe të NATO-s, me aftësi dhe përkushtim për disa vite. I falënderova ata për vendimin e Kanadasë për të vendosur qindra trupa të tjera për të përforcuar praninë tonë në rajon, si dhe aftësitë e tjera, duke përfshirë në ajër dhe në det”, -tha ai.

Në aktivitet morën pjesë edhe folës të tjerë të nivelit të lartë, përfshirë shefin japonez të mbrojtjes dhe ministrat e Mbrojtjes nga Zelanda e Re, Australia dhe Koreja e Jugut.

Fjalimi kryesor i Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, në Konferencën e Otavës për Sigurinë dhe Mbrojtjen, organizuar nga Konferenca e Shoqatave të Mbrojtjes (CDA)

“Ne takohemi në një kohë të errët për sigurinë tonë. Rusia ka shkatërruar paqen në Europë. Presidenti Putin ka nxitur një luftë brutale kundër Ukrainës paqësore dhe sovranë. Thjesht sepse guxon të zgjedhë rrugën e saj, rrugën e demokracisë dhe lirisë. Lufta e Presidentit Putin nuk është vetëm kundër ligjit ndërkombëtar, ajo kërkon të shkatërrojë të gjithë rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla, nga e cila varet paqja dhe siguria jonë. Mesazhi ynë për presidentin Putin është i qartë. Ndaloni këtë luftë. Tërhiqni forcat tuaja. Dhe angazhohuni në diplomaci.

Unë do të doja të njoh udhëheqjen e Presidentit Zelenskyy dhe trimërinë e jashtëzakonshme të popullit dhe forcave të armatosura ukrainase, teksa mbrojnë atdheun e tyre. Ne shohim me tmerr rritjen e viktimave civile, shkatërrimin e pakuptimtë të qyteteve dhe infrastrukturës dhe krizën masive humanitare. Kjo është një zemër e thyer për të gjithë ne, përfshirë Kanadanë, me komunitetin e saj të madh ukrainas. Si përgjigje, aleatët e NATO-s kanë rritur mbështetjen për Ukrainën, kanë imponuar kosto për Rusinë.

Duke forcuar frenimin dhe mbrojtjen tonë, aleatët po ofrojnë më shumë ndihmë ushtarake, humanitare dhe financiare për Ukrainën, për të ndihmuar Ukrainën të ruajë të drejtën e saj themelore për vetëmbrojtje, siç parashikohet në Kartën e OKB-së.

Në njëjtën kohë, ne po i imponojmë Rusisë kosto të paprecedentë, duke synuar kompanitë ruse,

bankat dhe furnizuesit e energjisë, si dhe oligarkët afër Presidentit Putin. Sektori privat po kontribuon gjithashtu, nga sektori i energjisë tek kompanitë e teknologjisë së lartë.

NATO ka përgjegjësinë për të

siguruar që ky konflikt të mos përshkallëzohet përtej Ukrainës, sepse kjo do të ishte edhe më e rrezikshme, shkatërruese dhe vdekjeprurëse, për Ukrainën dhe për të gjithë ne. Pra, aleatët gjithashtu po rrisin ndjeshëm

praninë tonë mbrojtëse në lindje të Aleancës sonë. Me mijëra trupa të tjera dhe qindra avionë dhe anije të tjera, kemi më shumë se dyfishuar praninë tonë atje në javët e fundit. Kjo përcjell një mesazh të qartë, se ne do të sigurojmë dhe mbrojmë çdo centimetër të territorit aleat.

Kanadaja po luan një rol udhëheqës në përgjigjen tonë. Për shumë vite, ju keni ndihmuar në forcimin e forcave dhe institucioneve të armatosura të Ukrainës, përfshirë trajnimin për dhjetëra mijëra trupa ukrainase, shumë prej të cilëve sot janë në vijën e frontit. Ju gjithashtu i keni dhënë Ukrainës qindra miliona dollarë mbështetje dhe pajisjet e nevojshme. Të gjithë jemi të frymëzuar nga mënyra se si forcat ukrainase po i rezistojnë me guxim pushtimit rus. Mbështetja e Kanadasë ka ndihmuar për ta bërë këtë të mundur.

Kanadaja po jep gjithashtu një kontribut të rëndësishëm në forcimin më të madh të mbrojtjes sonë kolektive që nga fundi i Luftës së Ftohtë. Dje, siç thashë, isha me kryeministrin Trudeau dhe ministrin e Mbrojtjes Anand në Letoni. Aty ku Kanadaja ka udhëhequr grupin e betejës shumëkombëshe të NATO-s

me aftësi dhe përkushtim për disa vite. I falënderova ata për vendimin e Kanadasë për të vendosur qindra trupa të tjera për të përforcuar praninë tonë në rajon, si dhe aftësi të tjera, duke përfshirë në ajër dhe në det.

Por çfarëdo që të ndodhë në muajt në vijim, çfarëdo që Moskë kërkon të arrijë përmes dhunës dhe agresionit, do të dështojë. Ajo tashmë po dështon. Presidenti Putin dëshiron më pak NATO në kufijtë e Rusisë, por ai po merr më shumë NATO. Ai dëshiron të ndajë Europën dhe Amerikën e Veriut, por ne qëndrojmë më të bashkuar se kurrë. Ai dëshiron të mbajë peng kombet europiane me naftën dhe gazin rus. Në vend të kësaj, ai po i shtyn vendet të diversifikojnë furnizimet e tyre dhe lëvizin edhe më shpejt drejt një të ardhmeje të rinovueshme. Dhe mbi të gjitha, Presidenti Putin dëshiron të shuajë flakën e lirisë dhe demokracisë në Ukrainë. Por sado të errëta të jenë ditët dhe javët e ardhshme, flaka do të vazhdojë të digjet. Europa dhe Amerika e Veriut do të ndihmojnë për ta mbajtur atë flakë gjallë. Ne qëndrojmë në solidaritet me partnerin tonë, Ukrainën. Dhe ne do të sigurojmë dhe mbrojmë të gjithë aleatët e NATO-s”.

STËRVITJA “COLD RESPONSE 2022” NË VERIUN E LARTË

NATO dhe forcat partnere “përballen” me ngricën në Norvegji

“Gjatë javëve të ardhshme, forcat e armatosura aleate dhe partnere do të udhëtojnë nëpër hapësirën e madhe, ku do të kryejnë stërvitje luftarake, do të kapërcejnë në liqen të ngrirë dhe shumë më tepër se kaq. Gjithçka ka të bëjë me trajnimin e aftësive jetike, duke u siguruar që forcat tona të armatosura të jenë të përgatitura për t’iu përgjigjur çdo kërcënimi ose krize dhe t’i mbajnë vendet dhe njerëzit tanë të sigurt. Stërvitja “Cold Response 2022” po bashkon aleatët nga Europa dhe Amerika e Veriut, duke demonstruar lidhjen e qëndrueshme transatlantike në zemër të NATO-s”, -informon zyrtarisht NATO.

Bazat e stërvitjes

Rreth 30,000 trupa nga mbi 25 vende nga Europa dhe Amerika e Veriut, stërviten së bashku në ushtrimet e motit të ftohtë, në tokë, në ajër dhe në det në vendin e një Aleati të NATO-s.

Vendi, pra ku do të zhvillohet stërvitja, është Norvegjia dhe detet përreth, kurse periudha kohore kur do të zhvillohet kjo stërvitje është Mars-Prill 2022.

Qëllimi se pse zhvillohet kjo stërvitje është për të ndihmuar aleatët dhe partnerët të praktikojnë punën së bashku në mënyrë që ata të jenë të përgatitur për çdo situatë.

“Cold Response 2022”, është një stërvitje e planifikuar dhe e rregullt, të cilën Norvegjia e pret çdo dy herë në vit. Stërvitja e këtij viti u njoftua më shumë se tetë muaj më parë. Ajo nuk ka lidhje me pushtimin e përvokuar dhe të pajustifikuar të Ukrainës nga Rusia, të cilin NATO po i përgjigjet me masa parandaluese, proporcionale dhe jo shkalëzuese, thekson NATO.

“Përqafimi i të ftohtit” – NATO dhe operacionet e dimrit

Forcat aleate duhet të jenë të gatshme për të operuar në çdo mjedis në çdo kusht. Trajnimi në Norvegji i lejon aleatët dhe partnerët e NATO-s të praktikojnë aftësitë e tyre duke operuar në mjedise ekstreme dhe të thyera, nga fjordet e ngrira te detet e akullta e deri te malet e mbuluara me akull. Ka një arsye që Norvegjia pret Qendrën e Përsosmërisë së NATO-s për Operacionet e Motit të Ftohtë.

Por shumë aleatë të tjerë të NATO-s organizojnë stërvitje dhe ndihmojnë në zhvillimin e kësaj ekspertize gjithashtu, nga Baltiku shumë i ftohtë në plazhet e largëta vullkanike të Islandës deri në Arktikun e Lartë Kanadez.

Nga stërvitjet “Arctic Express” në “Trident Juncture”, një trashëgimi e gjatë ushtrimesh në Norvegji

Norvegjia ka organizuar stërvitje me aleatët dhe

partnerët e NATO-s që nga fillimi i viteve 950. Nga “Anchor Express” në “Northern Express”, “Atlas Express” në “inter Express”, gjatë dekadave Norvegjia ka ndihmuar aleatët dhe partnerët të mësojnë se si të veprojnë së bashku në terrenin e saj të ashpër verior. Vetë stërvitja “Cold Response” u mbajt për herë të parë në vitin 200. Të shumta janë pamjet dhe faktet arkivore të ushtarëve gjatë këtyre ushtrimeve në fshatin e bukur norvegjez ku ata stërviteshin.

Po pse NATO bën Stërvitje?

Stërvitjet e rregullta lejojnë NATO-n dhe partnerët të ushtrohen së bashku, duke identifikuar se çfarë funksionon dhe çfarë duhet të përmirësohet. Ushtrimet janë mbrojtëse, proporcionale dhe të shpallura muaj më parë. Aleatët e NATO-s respektojnë detyrimet e transparencës sipas Dokumentit të OSBE-së të Vjenës, i cili rregullon rregullat për stërvitjet ushtarake në zonën euroatlantike.

Sipas detyrimeve të transparencës të Dokumentit të Vjenës, Norvegjia ka ftuar të gjitha vendet anëtare të OSBE-së që të dërgojnë vëzhgues në stërvitje. Shefi i Shtabit të Përbashkët Norvegjez gjithashtu informoi Komandantin e Flotës Veriore Ruse për “Reagimin e Ftohtë 2022”, në një video-telefonatë në janar 2022.

Arma e "besuar" e Putin, që po vret rusët në Ukrainë



HYSNI GJERGJI

Fillimi i pushtimit dhe marrja e vendimit për ta filluar luftën, sigurisht ka qenë një proces i gjatë vlerësimi i situatës në Ukrainë nga drejtuesit e lartë të shtetit dhe të ushtrisë ruse. Njohja e armikut, e aftësive dhe mundësive, e moralit dhe e pajisjeve të tij, është pika e parë në marrjen e vendimit luftarak ushtarak. "Nëse njeh armikun dhe vetveten atëherë nuk duhet t'u frikësohesh qindra betejave", -na mëson Sun Tzu në artin e Luftës. Kjo detyrë ishte ekskluzivisht e zbulimit rus, i cili deri më 23 shkurt, një ditë para sulmit, duket qartë se ka sugjeruar tek Putin, një Ukrainë të dobët ushtarakisht, ekonomikisht, moralisht dhe lehtësisht të pushtueshme.

Shërbimi i zbulimit rus FSB (Federalnaya Sluzhba Bezopasnosti), rezultoi të jetë e pasaktë, ose e informuar keq, të paktën për ditët e para të sulmit. Nuk mund të besohej që krenaria ruse e inteligjencës, është mashtruar, ka dhënë informacion të pa analizuar mirë apo të rremë lidhur me rezistencën e pritshme ukrainase. "Nëse kundërshtari gabon, mos e ndërprit atë", -ky parim i luftës duket se është i suksesshëm nga shërbimet e sigurisë ukrainase (SBU).

Çfarë ndodhi që gaboi në parashikim inteligjenca ruse? Mashtrim? Vlerësim i mangët apo kurth i koordinuar? Si do që të jetë, e vërteta është se arma e dashur e Putin është e pasuksesshme në vlerësimin dhe analizimin e situatës së pritshme të para sulmit në Ukrainë. Në shoqëritë autoritare shërbimet e inteligjencës janë shërbëtoresh besnike të liderëve dhe zakonisht "Shërbimet sekrete shkruajnë atë çfarë udhëheqësit i pëlqen të lexojë". Frustrimi i drejtuesve të institucioneve të sigurisë nga ana e Putin u duk qartë në një video të shpërndarë nga BBC, në ditën e njohjes zyrtare të Donetsk dhe Luhansk, më 23 shkurt. Në raportimin e shefit të SVR (Sluzhba Vneshney Razvedki), Sergei Naryshkin, Putin i bën presion hapur para medias disa herë për të qartësuar dhe shprehur qëndrimin e tij, duke e vënë në situatë dukshëm të sikletshme.

Zbulimi i jashtëm rus me shumë gjasa para pushtimit i sugjeroi Putinit se Ukraina ishte shtet i përshtatshëm, i dobët dhe i gatshëm për t'u përmbytur. Fillimi i luftës tregoi të kundërtën dhe rezultoi të rrisë moralin dhe gatishmërinë e ukrainasve për të rezistuar në mënyrë të pakapashkueshme. Shumë ushtarë rusë vërtetojnë pritshmëritë që kishin para sulmit. Të kapurit rob, ushtarët rusë deklarojnë se ishin të bindur që do të priteshin "me lule" si "shpëtimtarë", madje nuk do kishin nevojë të përdornin fare armët.

Ushtria ruse sigurisht është e aftë të mposhtë forcat e armatosura të Ukrainës, por perspektiva e pushtimit të një vendi armiqësor, është diçka tjetër. Kjo përbën një sfidë të madhe afatgjatë për Moskën. Mposhtja e ushtrisë dhe pushtimi i vendit janë dy gjëra të ndryshme.



Në një studim të institutit mbretëror të studimeve për sigurinë nga Nick Reynolds dhe Jack Watling, në "Ukraina, e parë nga sytë e Rusisë", më datë 25 shkurt, analizojnë me hollësi se si një armë e themeluar nga Putin dështon në këtë mënyrë. Fjalimi i Putin para pushtimit u duk i qetë, i sigurt dhe i mirë informuar për fitoren e shpejtë.

Inteligjenca ukrainase ka shpërndarë në disa media raporte lidhur me "sondazhe" të kryera në Ukrainë, me një pyetësor të detajuar në lidhje me qëndrimin e popullit ukrainas për luftën dhe ecurinë e saj.

Sondazhet sociale ishin të kryera në të gjithë Ukrainën në shkurt 2022 dhe të porositura nga Drejtoria e Nëntë e Shërbimit Federal të Sigurisë së Rusisë (FSB).

A ka pasur "misinformation" apo "disinformation" në rastin e planifikimit të sulmit rus mbi Ukrainë? Vija e ndarjes midis tyre është herë-herë e padallueshme dhe e turbullt. "Misinformation" është një pasaktësi e cila rezultoi si përfundim i një procesi të ndershëm ndoshta dhe neglizhent. Ndërsa "disinformation" është informacion i manipuluar dhe i servirur qëllimshëm për të mashtruar kundërshtarin.

Gjatë luftës së ftohtë dega e pestë e KGB-së ka qenë përgjegjëse për kundërzbulimin në territoret e ish-Bashkimit Sovjetik. Kjo degë në vitin 1991 u shndërrua në një agjenci inteligjence që kishte subjekt të punës së saj fqinjët e Rusisë. Departamenti për Informacionin Operativ (DIO) është përgjegjës për grumbullimin e informacionit për "shtetet fqinje" të Rusisë, ndërsa Drejtoria e Nëntë në këtë departament mbulon Ukrainën. Kjo drejtori ka drejtuar dhe mbikëqyrur mbledhjen e inteligjencës mbi shoqërinë ukrainase për të informuar vendimmarrjen ruse gjatë shkurtit 2022.

Sipas sondazhit të DIO, ukrainasit në fillim të shkurtit 2022 ishin me shumicë, ishin pesimistë për të ardhmen dhe mosbesues për politikën e Kievit. Ukrainasit sipas DIO, nuk u besonin politikanëve, partive politike dhe shumicës së institucioneve të brendshme të Ukrainës. Shqetësimet kryesore të qytetarëve ukrainas ishin inflacioni shumë i lartë, korrupsioni dhe kostoja e rëndë e jetesës, duke i paraqitur këto perceptime në tendencë rritëse.

Besimi për zyrën e presidentit sipas FSB ishte 27%, dhe me 67% mosbesim. Presidenti Volodymyr Zelenskiy kishte vlerësime të dobëta deri në rreth 34% mbështetje. Ushtria e Ukrainës, si e

rregullt ashtu edhe ajo rezervë, gëzonte më shumë besim, me rreth 68% të popullsisë. Këtu vlerësohej nostalgjia e veteranëve dhe nuk u mor shumë seriozisht. Pushteti lokal dhe komunal paraqiteshin të mirë besuara vetëm me 40% të popullsisë.

Institucionet e tjera gëzonin mbështetje që varioje nga mediokre në të varfër, duke përfshirë policinë me 28% dhe shërbimet e brendshme të sigurisë së Ukrainës me 23%.

Besimi te parlamenti ukrainas dhe te partitë politike paraqitet i favorshëm për FSB-në, përkatësisht 11% deri 8%. Kur ishte pyetja për gatishmërinë për të shërbyer në ushtri, ose për t'i rezistuar një pushtimi të huaj, 40% e të anketuarve deklaruan se nuk do ta mbronin Ukrainën. Kjo shifër u quajt shumë e mirë për DIO të FSB, pasi vlerësohej të ishte akoma më i ulët, duke i shtuar kësaj qëndrimin patriotik dhe fshehjen e "frikës" të natyrshme.

Popullsia kishte një opinion të mirë për aftësitë e ushtrisë, deri në 51% e të anketuarve besonin se ushtria ukrainase kishte kapacitetin për të zmbarsur një forcë pushtuese. Ukrainasit, sipas sondazhit analitik të DIO, nuk besonin se prania ushtarake ruse, për të cilën 90% e të anketuarve ishin në dijeni, do të rezultonte domosdoshmërisht në pushtim.

Është e dukshme që Putin, në fjalimin e tij televiziv para pushtimit, foli gjerësisht për dështimet e qeverisjes ukrainase në terma dhe fakte që pasqyronin tablonë e skicuara nga sondazhet e DIO të FSB-së.

Pika të tjera të "armës së fortë" ruse u identifikuan gjithashtu në sondazhin e kryer, ishte fakti që më shumë se gjysma e popullsisë ukrainase u vlerësua se kishte një opinion të favorshëm për kishën Ruse. Shumë kisha që e konsiderojnë veten pjesë të juridiksionit të Patriarkanës së Moskës janë infiltruar nga shërbimet sekrete ruse, pasi e dinë fuqinë shpirtërore që ato përcjellin.

Mozaiku i plotë i mënyrës sesi perceptoheshin figurat dhe partitë e ndryshme politike i dha FSB-së gjithashtu një "informacion me vlerë". Në bazë të këtij sondazhi Moska do të vendoste se cilave prej tyre duhet t'i jepte përparësi për t'i mbështetur, detyruar, marginalizuar apo edhe eliminuar. Kur vlerësohet nga një perspektivë kombëtare atdhedashurie, popullsia ukrainase vlerësohej se kishte një nivel "modest" vendosmërie dhe patriotizmi.

Vlerësimi ishte i ndryshëm dhe i ndarë sipas rajoneve: veri, jug, lindje dhe perëndim. Në sondazh, FSB-ja

mori informacion se qëndrimet në jug dhe lindje të vendit shfaqin shumë më pak besim në shtetin ukrainas, nën 40%. Këto të dhëna të sondazhit janë përfshirë në planifikimin e pushtimit të Rusisë dhe ndikimet dhe vërtetimet e tyre në terren ia vlen të analizohen.

Është e qartë për sa thamë më lart, pse Putin, në fjalimin e tij televiziv para pushtimit, foli gjerësisht për dështimet e qeverisjes ukrainase në terma që pasqyronin tablonë e "skicuara" nga sondazhet e FSB-së. Institucionet në të cilat ukrainasit kanë më shumë besim ishin forcat e armatosura të rishtrukturuara dhe të mbështetura nga viti 2014, pas pushtimit rus të Krimesë. Ishin Forcat e armatosura ukrainase pikërisht ato kundër të cilave, Rusia vendosi të veprojë më shpejt dhe më me vendosmëri që në fillim të sulmit.

Në qytetet e Ukrainës, u vlerësua faktor i rëndësishëm çështja e mobilizimit popullor dhe rezistencës jo konvencionale qytetare. Megjithatë edhe këtu, ndryshimet rajonale janë të një rëndësie për t'u marrë parasysh.

Pak qytetarë të anketuar nga FSB-ja, u përgjigjën se do ta mbronin Ukrainën dhe kjo popullsi ishte e përqendruar në mënyrë të rregullt në jug dhe lindje të vendit. Për më tepër, mes atyre që thanë se nuk do të luftonin, 50% treguan se në rast lufte ata do të "përshtateshin dhe mbijetonin". Një pjesë e madhe e popullsisë në jug dhe në lindje të Ukrainës pranuan se do të ishin të hapura për t'u përshtatur okupimit. Besimi në shoqërinë civile dhe institucionet vullnetare u konsiderua i lartë dhe thirrja e Presidentit Zelensky për mobilizim do të mbledhë një numër të madh të të rriturve të moshës së aftë për t'u armatosur.

Megjithatë siç kemi shkruar më parë, janë organizatat e shoqërisë civile ato që forcat speciale ruse, të drejtura nga FSB, synojnë të blejnë, manipulojnë dhe shantazhojnë pa mëshirë.

Nëse gjeneralët që planifikuan pushtimin e Rusisë e morën seriozisht sondazhin, ndikimi i tij në strategjinë e pushtimit rus duket qartë.

Rusia sipas FSB-së, kishte një shans të mirë për të shkatërruar institucionet e besuara të Ukrainës dhe për të zëvendësuar ato që janë më pak të besueshme. Administratat e reja pushtuese do të ishin gjithashtu të këshillueshme që të përdornin gjuhën e anti-korrupsionit dhe të mbështeteshin në ofrimin e shërbimeve, si një mjet për të thithur pjesët e lëkundura të popullsisë, pasi 44% e popullsisë, sipas sondazhit, pret

të ketë vështirësi për të paguar faturat e shërbimeve në fillim të shkurtit 2022.

Putini e ka përdorur tashmë këtë "sondazh" në fjalimet e tij publike. Por nga ana tjetër korrupsioni endemik në Rusi dhe varfërimi i Donetskut dhe Luhanskut të pushtuar që nga viti 2014, e vë në dyshim pritshmërinë nëse administratat pushtuese ruse do të bindin popullatën për një qeverisje më të mirë. Bazuar në sondazh, Rusia shpresonte se tronditja dhe frika në shkatërrimin e ushtrisë ukrainase mund të pengonin rezistencën, përvoja historike e luftërave dhe pushtimeve tregon rezultatin e kundërt.

Problemi me sondazhet sociale është se ato janë një pamje e një momenti në një kohë dhe situatë të caktuar. Por një ndryshim drastik i kontekstit mund të shkaktojë ndryshime të mëdha në ndjenja dhe qëndrime që ndryshojnë rrënjësisht.

Sulmet ajrore, edhe kur kufizohen në sulme me saktësi ndaj objektivave ushtarake, historikisht janë perceptuar shumë negativisht nga popullsitë civile nën bombardim.

Shumica e popullsisë mund të mos e kuptojë plotësisht ndryshimin midis bombardimeve të zonës civile të banuar dhe objektivave ushtarake. Kjo shpesh nxit urrejtje të fortë ndaj agresorit dhe forcon vendosmërinë për të rezistuar.

Viktimat ushtarake përballë një pushtimi tokësor të armikut mund ta bëjnë një popullsi më të vendosur për të rezistuar, për sa kohë që rezistenca nuk duket e pashpresë. Fitoret e vogla, por simbolike të rëndësishme të Ukrainës, si p.sh. rimarrja e aeroportit Antonov, vrasja e gjeneralëve rusë, kapja rob e shumë të tjerëve, rrëzimi i avionëve etj., marrin rëndësi më të madhe kur shikohen si shpresëdhënëse për të ardhmen e konfliktit.

Sondazhi i FSB-së mund të ketë qenë i saktë në matjen e opinionëve në kohën kur u krye, por ai nuk u tregoi vendimmarrësve rusë se si mund të evoluonin ndjenjat njerëzore pas një pushtimi ushtarak.

Rusia po bindet se po përballet me rezistencë të ashpër civile dhe sulme kryengritëse, dhe kjo ka çuar në rritjen e përdorimit të fuqisë së zjarrit në zonat urbane. Pikërisht kjo, po ndodh tani. Nuk kursehen objektiva civilë dhe ato me rrezik të jashtëzakonshëm nuklear, pasi situata është jashtë pritshmërive.

Nga ana tjetër shikohet një aktivitet "Special" dhe "smart" i shërbimit të sigurisë së Ukrainës (SBU), i cili zbulon dhe vret për tradhti të lartë si bashkëpunëtor rus, negociatorin e saj në bisedime me Rusinë, Denis Kireev, më datë 5 mars. Gjeneralmajor Andrey Sukhovetsky i Spetsnaz, raportohet i vrarë nga një snajper ukrainas nga një distancë rreth 1,5 km, më 2 mars. Ai ishte zëvendëskomandant i divizionit të 41 parashutist. Gjeneralmajor Vital Gerasimov është një tjetër ushtarak i lartë që raportohet i vrarë nga ukrainasit në Kharkiv.

SBU rezultoi të ketë kapur shumë robër rusë, si dhe informacione të klasifikuara të cilat do të përdoren gjatë rezistencës ukrainase. Numri i vrasjeve dhe dëmeve të raportuara, sado i ekzagjeruar të jetë, është përsëri i madh në njësinë e kohës së shkurtër prej 14 ditësh luftim. Roli i inteligjencës është i rëndësishëm për dy palët ndërluftuese dhe do të bëhet publik hap pas hapi, sipas interesit të palës së interesuar, sigurisht.



Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Gruas këtë vit, jo vetëm në Kosovë por anë e mbanë botës, përkon me një kohë kur ne po ballafaqohemi me sfida të mëdha, duke përfshirë rritjen e rasteve të dhunës në familje, rasteve evidente të diskriminimit mbi bazë gjinore, pabarazisë shoqërore, dhunës e etiketimeve në platforma elektronike e rrjete sociale si dhe të papunësisë së lartë në mesin e grave dhe vajzave.



Presidentja Osmani: Për çdo ditë të jetës suaj, do ta keni përherë një krah për t'u mbështetur dhe përherë një dorë të zgjatur

Presidentja Vjosa Osmani në ditën Ndërkombëtare të Gruas, me temën "Zhbëjmë paragjykimet, punojmë për gjithëpërfshirjen" do të drejtohej me një urim publik të gjitha vajzave, grave, motrave, nënave.

"Uroj që në 365 ditët në vijim, fjalët grua dhe vajzë të vazhdojnë të jenë sinonim të triumfit, suksesit, ngadhënjimit e inspirimit - ashtu siç ishin shumë vajza dhe gra në vitin që po e lëmë pas.

Uroj që përgjatë vitit në vijim, fuqizimi ekonomik i vajzave dhe grave të shërbejë si bosht rreth të cilit konceptohet e ideohet programi dhe politikat e zhvillimit ekonomik.

Uroj që në ditë dhe muajt në vijim, vajzat dhe gratë tona do të gëzojnë respektin e merituar, trajtimin dinjitoz, e mbështetje të pakursyer.

Uroj që në vitin që pason, vajzat e gratë tona të ndihen të sigurta në shtëpi, në rrugë, në lagje e në çdo hapësirë publike.

Uroj për qasje të barabartë për vajzat e gratë në arsim, në drejtësi, në ekonomi, në politikbërje, në procese kyçe vendimmarrëse, në trashëgimi e në çdo sferë tjetër të jetës.

Uroj përfundimisht për barazi në mes të 'atij' dhe 'asaj'. Sa më shumë që jetësohet ky synim, aq më mirë do të jetë për të gjithë ne si dhe për vendin dhe shoqërinë tonë.

Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Gruas këtë vit, jo vetëm në Kosovë por anë e mbanë botës, përkon me një kohë kur ne po ballafaqohemi me sfida të mëdha, duke përfshirë rritjen e rasteve të dhunës në familje, rasteve evidente të diskriminimit mbi bazë gjinore, pabarazisë shoqërore, dhunës e etiketimeve në platforma elektronike e rrjete sociale si dhe të papunësisë së lartë në mesin e grave dhe vajzave.

Këto probleme nuk e kanë gjen-ezën në ditët e muajt që po i lëmë pas. Përkundrazi, janë një reflektim i qartë i pabarazive të trashëguara brez pas brezi.

Por, është e qartë tashmë se barazia gjinore dhe të drejtat e grave janë themelore dhe janë parakusht për adresimin e të gjitha sfidave që i për-menda. Ne mund të arrijmë prosperitet, siguri dhe stabilitet vetëm atëherë kur do të promovojmë, mbrojmë e garantojmë të drejtat e grave dhe të vajzave.

Për dekada gratë kanë thirrur për barazi. Për dekada gratë përsërisin se "Ka ardhur koha" - koha për barazi, për mundësi, për përfqësim; koha për t'i dhënë fund dhunës, koha për qasje në drejtësi, për mundësi të barabarta në trashëgimi.

Prandaj, duhet të bashkohemi që të gjithë - gra e vajza, burra e djem, të rinj e të moshuar që t'i japim frymë barazisë gjinore në shtëpi, në rrugë, në vende pune, në institucione, në komunitet e kudo tjetër.

E dimë të gjithë se ligjet në parim tingëllojnë mirë e kanë përmbajtje deri diku të kënaqshme. Por nga fjalët tek veprat, hendeuku vazhdon të jetë i thellë. Dhe kjo është sfida jonë e përbashkët, qoftë e institucioneve ashtu



edhe e shoqërisë në përgjithësi. Ky mbetet përkushtimi ynë prioritar dhe angazhimi ynë i përditshëm. Ky ishte motivi pse një prej 3 komponentëve të rëndësishme në kuadër të zotimeve për Samitin për Demokraci në SH A ia dedikuam pikërisht barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave dhe vajzave. Jam shumë e lumtur që po punojmë për së afërmi së bashku me shumë prej jush në mënyrë që t'i plotësojmë këto përkushtime.

Na duhet mobilizim e vendosmëri, sepse brumin e kemi të gatshëm tashmë. Rikujtoj se vitin e kaluar, Kosova me më pak se dy milionë banorë ktheu në shtëpi dy medalje të arta nga Lojërat Olimpikë, nga dy vajza tona të arta. Emri i Kosovës u ngrit e triumfoi lartë anë e mbanë botës, nga sporti te kin-

ematografia, nga muzika e deri te arti dhe shkencat. Vajzat e gratë dëshmuuan se ia dalin shkëlqyeshëm dhe ia zbardhin fytyrën shtetit tonë.

Por, të nderuar pjesëmarrës, po kaq sa janë shtuar sukseset, po kaq vazhdojnë të frymojnë me njëfarë kokëfortësie edhe paragjykimet dhe stereotipet karshi vajzave dhe grave.

Vajzat dhe gratë lehtësisht kategorizohen e etiketohen, përpara se të dëgjohen e të vlerësohen. Vajzat dhe gratë sulmohen, përpara se të respektohen e trajtohen me dinjitet. Vajzat e gratë refuzohen, përpara se t'u hapen dyert, sepse ka gjithnjë një arsytim, gjithnjë një pengesë, gjithnjë një dyshim. Për mua e koleget e mia këtu që janë në politikë, gjithnjë ajo çka veshim është më me rëndësi se ajo çka ne punojmë.

Përderisa gratë shihen vetëm nën prizmin biologjik e tentohet vazhdimisht t'i zhveshin nga kontributi social, nga personaliteti, nga identiteti profesional - problemet dhe sfidat do të jenë të vazhdueshme e serioze.

Shpeshherë tentoj të mos i shpërfaq në plotëni barrierat e shumta me të cilat jam ballafaquar përgjatë rrugëtimit profesional e politik, këtë besoj e bëjnë shumica prej juve grave. Sepse, në një mënyrë të tillë, sikurse shpresojmë se do të parandalojmë dekurajimin e shumë vajzave për të ecur hapave të njëjtë. Por, fundja, kjo ka pak rëndësi, sepse rrugëtimet e sfidat janë individuale. Ajo që ka rëndësi është se ne jemi këtu për secilën grua dhe vajzë dhe se përkundër çdo pengese eventuale, do ta keni përherë një krah për t'u mbështetur

dhe përherë një dorë të zgjatur.

Por, do të hasni edhe në shumë fjalë e paragjykimet; do të ballafaqoheni me shumë etiketime nga të cilat shumicën e rasteve do të kursehen kolegët tuaj burra, do të tentojnë t'ua ulin moralin e t'ju bëjnë të ndiheni të pavlerë, por secilën herë ju lus të kujtoni gjyshtet tuaja që sfiduan paragjykimet, nënat tuaja që sfiduan patriarkatin, gratë që udhëhoqën rezistencën për liri e demokraci, vajzat që nuk e pranuan refuzimin dhe mospranimin nga shoqëria, vajzat që sfiduan stereotipet, gratë që dëshmuuan që asnjë punë nuk është ekskluzivisht vetëm për burra - kujtoni e inspironi nga shembulli i pashoq i kampioneve tona të përditshme. Ato janë dëshmia më e pastër se si përmes luftimit të paragjykimëve e stereotipeve, hap pas hapi shkojmë drejt garantimit të gjithëpërfshirjes. Të nderuara gra e vajza, uroj që dita Ndërkombëtare e Gruas të shndërrohet vit pas viti në ditë ku festojmë arrijtjet e shënojmë progres karshi pengesave e sfidave, të cilat jam e bindur do t'i tejkalojmë së bashku të gjitha ne, po edhe së bashku me burra kampion të cilët e kuptojnë se barazia gjinore është në të mirë të të gjithë shoqërisë dhe shtetit tonë. Uroj që në këtë ditë të gëzojmë gjithnjë të arriturat individuale të cilat përfundimisht do të reflektohen në përmirësimin e mirëqenies sonë kolektive."

Ministri Mehaj: Roli i grave dhe vajzave, i jashtëzakonshëm në të gjitha periudhat historike

Në ambientet e Kazermës "Adem Jashari" në Prishtinë, në një organizim të veçantë të Ministrisë së Mbrojtjes, me temën "Gratë, Paqja dhe Siguria", u shënuar 8 Marsi- Dita Ndërkombëtare e Gruas.

Ky aktivitetet, u organizua me pjesëmarrjen e grave dhe vajzave zyrtare dhe ushtarake të FSK-së, si dhe veteraneve të UÇK-së dhe ish-TMK-së, ku të pranishëm ishin edhe Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, Zv. Ministri Shemsi Sylja, Zv. Komandanti i FSK-së, Gjeneral major Enver Cikaqi dhe Drejtori i Drejtorisë së Inteligjencës dhe Sigurisë, Gjeneral major Gëzim Hazrolli, Komandanti i Komandës së Logjistikës, Gjeneral brigade Naim Haziri dhe Drejtori i NALT-it, Gjeneral brigade Jörg Rüter.

Me këtë rast, të pranishme, me fjalë rasti i përshëndeti, Ministri Mehaj, i cili prezantoi rolin e



madh të grave e vajzave tona në të gjitha periudhat historike të përpjekjeve për liri, pavarësi dhe shtetndërtimin e vendit.

Gjithashtu, ministri Mehaj vlerësoi lartë kontributin e grave dhe vajzave zyrtare e ushtarake në Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK në realizimin e detyrave ligjore dhe misionin kushtetues të tyre, në shërbim të vendit, qytetarëve si dhe paqes e sigurisë kudo në otë.

Në vazhdim, në tematikën shumëdimensionale të ditës festive, me fjalimet dhe kumtesat e tyre u paraqitën edhe Gjeneral major Enver Cikaqi, Gjeneral brigade Irfete Spahiu, Znj. Fahrije Sadiku, kadetja e SU-së, Alisa Ramadani dhe Nënkolonele Remzije Zeqiraj.

Më herët ministri Mehaj, ka pritur për herë të parë një grup të veteraneve të UÇK-së dhe TMK-së, të cilave u shprehu mirënjohjen e lartë për kontributin dhe shërbimin e jashtëzakonshëm për Lirinë dhe Pavarësinë e vendit.

Dita Ndërkombëtare e Gruas - Ndërtimi i shoqërive ku të gjithë kanë të drejta dhe mundësi të barabarta

Ursula von der Leyen: Barazia gjinore, një synim kritik për shëndetin dhe pasurinë e shoqërive tona

Barazia midis grave dhe burave është një nga vlerat e Bashkimit European. Është shkruar në traktatet themeluese të Bashkimit. Dhe ky është një qëllim që Instituti European për Barazinë Gjinore (EIGE) është krenar të ndihmojë Shtetet Anëtare të BE-së të punojnë drejt arritjes së tij.

Dy vitet e fundit, Dita Ndërkombëtare e Gruas u zhvillua në kuadrin e një pandemie globale. Këtë vit, kjo ndodh në sfondin e luftës në kufijtë e BE-së, si dhe një krizë humanitare që po shfaqet me shpejtësi.

Barazia gjinore mbetet një synim që është kritik për shëndetin dhe pasurinë e shoqërive tona. Dhe ky është një objektiv që nuk mund ta arrijmë rastësisht. Përfitimet që janë arritur në barazinë gjinore, që nga nënshkrimi i traktateve të BE-së në 1957, janë rezultat i punës së palodhur, duke përfshirë ligjet, fushatat dhe aktet individuale të guximit.

Komisioni propozon rregulla në mbarë BE-në për të luftuar dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje

Komisioni European po propozon rregulla në mbarë BE-në për të luftuar dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje. Direktiva e propozuar do të kriminalizojë përdhunimin në bazë të mungesës së pëlqimit, gjykimin gjenital femëror dhe dhunën kibernetike, e cila përfshin: ndarjen jo konsensuale të imazheve intime; ndjekja kibernetike; ngacmimi kibernetik; dhe nxitje kibernetike për dhunë ose urrejtje. Rregullat e reja forcojnë gjithashtu aksesin e viktimave në drejtësi dhe inkurajojnë shtetet anëtare të zbatojnë një mekanizëm me një ndalesë, që do të thotë se të gjitha shërbimet e mbështetjes dhe mbrojtjes do të vendosen në të njëjtin vend. Viktimat duhet të jenë në gjendje të kërkojnë kompensim gjatë procedurës penale. Propozimi kërkon gjithashtu mbrojtje dhe mbështetje adekuate dhe të specializuara, për shembull, nëpërmjet linjave ndihmëse pa pagesë dhe qendrave të krizave të përdhunimeve. Ai gjithashtu siguron mbështetje të synuar për grupet me nevojat specifike ose në rrezik, duke përfshirë gratë që ikin nga konflikti i armatosur.

Elementet kryesorë të rregullave të reja të propozuara:

Kriminalizimi i përdhunimit, gjykimin gjenital femëror dhe dhunën kibernetike. Komisioni propozon që të kriminalizohen veprat e mëposhtme në të gjithë BE-në: përdhunimi në bazë të mungesës së pëlqimit; Gjykimin gjenital femëror (FGM); ndjekja kibernetike; ndarja jo konsensuale e imazheve intime; ngacmimi kibernetik;



dhe nxitja kibernetike për urrejtje ose dhunë.

Propozimi plotëson Aktin e Shërbimeve Dixhitale (DSA) duke e bërë atë funksional duke përcaktuar përmbytje të paligjshme në internet në lidhje me dhunën kibernetike. Ai gjithashtu do të lejojë që procedurat e shpejta gjyqësore të heqin me shpejtësi përmbytjen përkatëse në internet.

Procedurat e raportimit të sigurt dhe vlerësimit të rrezikut

Propozimi trajton mos raportimin e dhunës ndaj grave që ekziston ende sot. Ai prezanton mënyra të reja për të raportuar aktet e dhunës, të cilat janë të ndjeshme ndaj gjinisë, më të sigurta, më të lehta, më të aksesueshme - përfshirë online - dhe miqësore për fëmijët. Profesionistët, si punonjësit e kujdesit shëndetësor apo psikiatër, nuk do të pengohen më nga regjimet e konfidencialitetit për të raportuar çdo dyshim të arsyeshëm për një rrezik të afërt të dëmtimit të rëndë fizik. Autoritetet do të jenë gjithashtu të detyruara të kryejnë vlerësime individuale të rrezikut kur viktimat kontakton për herë të parë, për të vlerësuar rrezikun e paraqitur nga shkelësi. Mbi këtë bazë, autoritetet do të duhet të ofrojnë mbrojtje të menjëhershme përmes ndalimit emergjent ose urdhrave të mbrojtjes.

Respektimi i privatësisë së viktimave në proceset gjyqësore dhe e drejta për kompensim

Komisioni propozon që provat ose pyetjet në lidhje me jetën private të viktimave, veçanërisht historinë e tyre seksuale, mund të përdoren vetëm kur është rreptësisht e nevojshme. Viktimat do të kenë të drejtën të kërkojnë kompensim të plotë nga shkelësit për dëmet, duke përfshirë kostot e kujdesit shëndetësor, shërbimeve mbështetëse,

të ardhurave të humbura, dëmtimit fizik dhe psikologjik. Ata gjithashtu duhet të jenë në gjendje të marrin kompensim gjatë procedurës penale.

Mbështetje për viktimat përmes linjave të ndihmës dhe qendrave të krizës së përdhunimeve

Për të adresuar nevojat shumë specifike të viktimave të dhunës seksuale, Komisioni po propozon që Shtetet Anëtare të ofrojnë shërbime të dedikuara duke përfshirë qendrat e krizës së përdhunimit. Viktimat në një rrezik në rritje të dhunës, duke përfshirë gratë që ikin nga konflikti i armatosur, duhet të marrin mbështetje të synuar nga Shtetet Anëtare. Linja kombëtare e ndihmës për të mbështetur viktimat e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje duhet të jetë e disponueshme 24/7, gjatë gjithë vitit dhe të jetë pa pagesë. Kur një viktimë është fëmijë, autoritetet duhet të ofrojnë mbështetje të përshtatshme për moshën në interesin më të mirë të fëmijës. Viktimat e dhunës kibernetike do të kenë gjithashtu të drejtën e mbështetjes adekuate, duke përfshirë këshilla se si të kërkojnë ndihmë ligjore dhe si të heqin përmbytjen në internet. Në rastet e ngacmimeve seksuale në punë, duhet të vihen në dispozicion shërbimet e këshillimit të jashtëm për viktimat dhe punëdhënësit.

Koordinim dhe bashkëpunim më i mirë

Shtetet anëtare duhet të shkëmbejnë praktikatat më të mira dhe të konsultohen me njëri-tjetrin në çështjet penale, duke përfshirë përmes Eurojust-it dhe Rrjetit Gjyqësor European. Për të gjurmuar progresin dhe për të monitoruar situatën në të gjitha Shtetet Anëtare, Komisioni po propozon gjithashtu një detyrim për Shtetet Anëtare për të mbledhur të

dhëna për dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje për t'u përfshirë në një anketë në mbarë BE-në çdo pesë vjet.

Raporti 2022 mbi Barazinë Gjinore

Komisioni po publikon edicionin e vitit 2022 të raportit vjetor të Komisionit European për barazinë gjinore në BE. Në vitin 2021 u ndërmorën hapa të rëndësishëm për sa i përket propozimeve legislative, përkatësisht për transparencën e pagave dhe pagat minimale adekuate në BE, si dhe për një Akt të ri të Shërbimeve Dixhitale (DSA), i cili do të ndihmojë në mbrojtjen e përdoruesve në internet. Në dhjetor 2021, Komisioni propozoi gjithashtu përfshirjen e gjuhës së urrejtjes dhe krimit të urrejtjes në listën e krimeve të BE-së.

Raporti gjithashtu tregon se gratë janë ndikuar në mënyrë disproporcionale nga pandemia. Gjatë vitit 2020, pjesëmarrja e grave në fuqinë punëtore ra me 0.5% nga viti 2019, pas një dekade rritjeje të qëndrueshme. Dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje gjithashtu mbeten të përhapura në BE dhe gjithashtu është përkeqësuar nga pandemia, duke përfshirë dhunën në internet.

Siç tregon edhe raporti, dështimi për të trajtuar dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje kushton para – rreth 289 miliardë euro në vit.

Anëtarët e Kolegjit u shprehën:

Presidentja e Komisionit European, Ursula von der Leyen, tha: “Unë dua që Europa të jetë në krah të grave me mbrojtje dhe mbështetje. Unë dua një shoqëri ku dhuna ndaj grave parandalohet, dënohet dhe ndiqet penalisht kur ndodh. Koha për drejtësi dhe barazi është tani. Kjo është arsyeja pse ne dalim sot me rregullat e duhura për të përsheptuar ndryshimin.”

Zëvendës presidentja për Vlerat

dhe Transparencën, Vera Jourová tha: “Shumë gra dhe vajza vuajnë nga përdhunimi, ngacmimi ose abuzimi. Nuk ka vend për këtë në Europën moderne. Fatkeqësisht, situata nuk po përmirësohet sa duhet dhe dhuna po rritet në internet. Sot, ne po propozojmë për herë të parë ligjin në mbarë BE-në për të luftuar dhunën ndaj grave. Kjo do të ofrojë mjete reale për viktimat. Autorët duhet të përballen me pasojat e veprimeve të tyre.”

Komisionerja për Barazinë, Helena Dalli tha: “Dhuna ndaj grave cenon drejtpërdrejt barazinë e grave, duke ndikuar në aftësinë tonë për të lulëzuar dhe udhëhequr në shoqëri. Qëllimi dhe angazhimet e Komisionit janë të qarta. Sot, ne po shtojmë përpara një propozim legjislativ gjithëpërfshirës për të luftuar dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, duke përmbytur standardet ndërkombëtare. Me këtë propozim, ne do të bëjmë një ndryshim për gratë dhe vajzat në të gjithë Europën.”

Nevoja për të parandaluar dhe luftuar dhunën ndaj grave, mbrojtjen e viktimave dhe ndëshkimin e shkelësve u shpall, në Udhëzimet Politike të Presidentes von der Leyen, si një prioritet kyç për Komisionin dhe është pjesë e Strategjisë për Barazinë Gjinore 2020-2025.

Dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje janë të përhapura në të gjithë BE-në dhe vlerësohet se prek 1 në 3 gra në BE. Një në dy kanë përjetuar ngacmime seksuale. Një në 20 gra raportojnë se janë përdhunuar. Dhuna në internet është gjithashtu në rritje, duke synuar veçanërisht gratë në jetën publike, si gazetarët dhe politikanët. 1 në 2 gra të reja përjetuan dhunë kibernetike me bazë gjinore. Gratë gjithashtu përjetojnë dhunë në punë: rreth një e treta e grave në BE që janë përballur me ngacmime seksuale e kanë përjetuar atë në punë.

Parlamenti European, si dhe OJQ-të në të gjithë BE-në dhe organizatat për të drejtat e viktimave, kanë kërkuar vazhdimisht një legjislacion për dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, si dhe për dhunën kibernetike ndaj grave në përgjithësi.

Si pjesë e punës së vazhdueshme të Komisionit për të trajtuar dhunën me bazë gjinore dhe për të promovuar barazinë dhe në kuadër të programit të ri të financimit 1.55 miliardë euro për Qytetarët, Barazitë, të Drejtat dhe Vlerat, në vitin 2022, 30.5 milionë euro janë tani në dispozicion për projektet që parandalojnë dhe luftojnë dhunën ndaj grave dhe fëmijët si dhe 6.8 milionë euro për projekte që promovojnë gëzimin e plotë të të drejtave të grave, lirinë nga stereotipet gjinore, ekuilibrin punë-jetë, fuqizimin e grave dhe integrimin gjinor.

"M'u desh shumë kohë për të pasur një zë që të dëgjohet dhe tani që e kam, nuk do të hesht"

Punoi: Shefe e Sektorit të Botimeve,
ANJEZA MUSOLLARI

Problemi i luftës dhe i paqes do të ndryshojë krejtësisht ditën kur femrat do të kontribuojnë aq sa meshkujt në fatin e njerëzimit. Nënata dhe gratë kanë vetëm një përgjigje: paqe.

Ja pse bota rrotullohet rreth femrës, sepse ajo kujdeset për botën. Kujdeset që ajo të ecë drejt. Nuk është e lehtë të mbash botën mbi supe, por femra e bën duke sfiduar çdo fuqi mashkullore. Kujdeset që ta bëjë botën një vend më të bukur, duke e nisur nga vetja.

Më thoni diçka që mund t'ju magjepsë më shumë se një femër e bukur! Absolutisht asgjë.

Dhe ajo që do t'ju çudisë më shumë është fakti që femra e çdo specieje gjitarësh jeton më shumë se mashkulli. Ku ka më bukur se të vazhdojë kujdesi në pafundësi.

"Reflektoni!"

Mos i vritni,

mos i prekni me duar të pista...

Duaji femrat çdo ditë!!"

Sepse kështu do bijën, motrën, nënën, gruan.

Nuk kam takuar asnjëherë një femër që nuk është e fortë, por ndonjëherë ato nuk dinë ta tregojnë forcën që kanë. Duhet një tragjedi që një femër të shfaqë forcën e saj. "Shfaqeni forcën përpara tragjedisë".

Data 8 Mars, kremtohet si dita e gruas, e qenies që sjell jetën, që krijon botën, e qenies së frymës së parë e të fundit. Në mes historive frymëzuese për një ditë të shënuar si kjo, kujtojmë ato, gratë që formuan historinë, ato që krijuan një tokë, një bazë, ato që edhe sot na bëjnë krenare. Gatë shqiptare që shkruhen me shkronja të mëdha në fletët e historisë por edhe ato që na bëjnë krenare sot nëpër botë.

Gratë ndryshuan botën me kontributet e tyre të mëdha në shkencë, politikë, teknologji, art, sport, argëtim, etj., duke siguruar se e ardhmja mund të jetë FEMËR.

Sevasti Qiriaz ka hapur shkollën e parë shqipe të vashave, në 1891 në Korçë.

Parashqevi Qiriaz ka organizuar shoqatën e parë të gruas, në Korçë në vitin 1909, e së bashku me Sevastinë, kanë botuar të parën revistë për gratë, "Ylli i Mëngjesit" në Boston, më 15 janar 1917. Këto motra të famshme hapën dhe të parën shkollë të mesme për femra në Kamëz, Institutin Kiriaz, në vitin 1922.

Kushe Mica ka hapur shkollën e parë femërore në Shkodër, në 1862.

Persefoni Treni ishte drejtuesja e parë e një shkolle për vajza, në Pogradec në 1917.

Urani Rambo hapi shkollën e parë femërore në Gjirokastër në 1920, dhe në 1923 bëri kërkesën në konferencat e grave që meshkuj e femra të shkolloheshin së bashku.

Hajrie Kraja mësuesja e parë në një shkollë shtetërore, në Shkodër në 1920. Kanë thyer tabu dhe të gjitha vajzat që u regjistruan në shkollat e para të hapura nga zonjat e lartpërmendura.



Polikseni Luararsi, nxënësja e parë e regjistruar në një shkollë djemsh, në Korçë, më 7 mars 1887.

Ikbali Çika, femra e parë gazetare shqiptare dhe e para pronare femër (botuese) e revistës ekonomike-letrare "Java" në 1937. Ikbali hapi rrugën për fillimet e përfshirjes së femrave në të gjitha fushat e jetës.

Eleni Qirici, femra e parë shqiptare që aktroi në Hollywood. Diva kujdesej gjithnjë të vinte në pah faktin që ishte shqiptare.

Natyrisht që kanë thyer tabu të gjitha gratë e vajzat që guxuan të shkruanin e të botonin në shtypin e kohës, si Motrat Qiriaz, Kaliopi Plasari, Afërdita Erbapi, Emine Toptani, Marigo e Fereniqi Pozio, Selfixhe Broja, Xhemalije Gjylbegu, Luçije Serreqi, Ollga Pëllumbi etj.

Musine Kokalari ishte prozatore, politikane, poete, themeluese e partisë së parë social-demokratike në Shqipëri (1941); femra e parë ndër disidentët e parë të viteve të para të jetës nën komunizmin e llojit shqiptar; u përdoq, dënua, internua, harrua, braktis, vdiq në mjerim, e sëmurë rëndë, pa njeri pranë, madje as mjek. Musine Kokalari, femra e parë shqiptare shkrimtare, e arsimuar në perëndim (Itali), bëri emër letrar në vitet 1930 - '40.

Valentina Pistoli, 1928 është arkitektja e parë shqiptare. Studioi në Universitetin e Sofisë në Bullgari dhe ishte udhëheqëse e grupit të arkitektëve që e dizajnuan planin e "Hotel Tirana".

Qemoran Toptani, 1912-1981 ishte kirurgia e parë shqiptare. Pasi kreu shkollimin në Vjenë dhe Romë, u kthye në Tiranë ku u shqua si një ndër kirurget më të mira që shëruan të plagosurit e Luftës së

Dytë Botërore.

Dora d'Istria apo Elena Gjika, 1828-1888 ishte intelektuale dhe revolucionare shqiptare. Përpos spektrit intelektual ajo ndihmoi edhe në afirmimin e çështjes kombëtare. Elena Gjika u quajt në ato kohë Princesha e Kulturës Europiane. Në Europë, asokohë kishte mjaft femra të kulturara, por shumë pak arritën të ngjallnin respektin e botës mashkullore dhe Dora ishte njëra prej tyre.

Shaqe Çoba, 1875-1954, ishte një ndër gratë e para intelektuale që kontribuoi në ngritjen e figurës së gruas në shoqëri duke themeluar kështu edhe organizatën "Gruaja Shqiptare", më 1920.

Erifili Bezhani, 1917-1959 ishte avokatja e parë shqiptare e cila u diplomua për Drejtësi në Francë, ushtroi detyrën në Francë por u dënua tragjikisht nga regjimi komunist në Shqipëri.

Motrat Zengo, Sofia 1915-1976 dhe Androniqi 1913-2000, janë piktoreset e para shqiptare që njihen për pikturat e para profesioniste në historinë e artit pamor shqiptar.

Shote Galica është figura e pavdekshme historike, një Zhan d'Ark shqiptare. Shote luftoi 12 vjet kundër forcave serbe për çlirimin e Kosovës. Trimëresha shqiptare është shpallur Heroinë e Popullit.

Lejla Rasih Dino, një diplomate e sprovuar, në emër të grave shqiptare iu drejtua autoriteteve botërore për çështjen e trojeve shqiptare të mbetura jashtë kufijve të vitit 1913.

Ishte femra e parë shqiptare që i foli me kurajë, në kohën e duhur, Kryetarit të Konferencës së Paqes në Paris, për çështjen shqiptare.

Ajo iu drejtua personalitetit më në zë të politikës botërore, Woodrow Wilson dhe fitoi simpatinë e tij dhe të bashkëshortes. Luftoi për mbrojtjen e çështjes shqiptare në përgjithësi e të Kosovës e Çamërisë në veçanti.

Lejla Dino krijoi në Gjenevë të Zvicrës "Komunitetin e Gruas Shqiptare", në vitin 1919 dhe theksoi se SHBA ishte miku më i madh i Shqipërisë. Dhe realisht fjalët e saj qëndrojnë të vërteta edhe sot e kësaj dite.

Nënë Tereza: "Kam lindur në Shkup, jam shkolluar në Londër, jetoj në Kalkutë dhe punoj për të gjithë njerëzit e varfër në Botë. Atdheu im është një vend i vogël me emrin Shqipëri". Legjenda e gjallë Nënë Tereza, ishte nënë kujdestare e 7,500 fëmijëve në 60 shkolla, mjekonte 960,000 të sëmurë në 213 dispanser, ishte e vetmja në botë që trajtonte 47,000 viktima të lebrozës në 54 klinika, kujdesej për 3,400 pleq të braktisur e të lënë rrugëve, në 20 shtëpi pleqsh, kishte birësuar 160 fëmijë ilegjitimë e bonjakë.

Manushaqe Shehu, Gjeneralja e parë femër në Forcat e Armatosura në Shqipëri.

Gjatë karrierës së saj, Shehu është dekoruar me urdhra e medalje të ndryshme nga ministri i Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm.

Ajo është pjesëmarrëse në stërvitje të përbashkëta me vende anëtare të NATO-s dhe po ashtu aktiviste dhe drejtuese e nismave në ndihmë të grave ushtarake dhe civile të FA-së dhe të rajonit.

Është gruaja, që ka dhënë burra të aftë që kanë drejtuar dhe drejtojnë perandori, shtete, organizma

kombëtare dhe ndërkombëtare në të gjitha fushat si në organet e larta presidenciale, legislative, juridike, ekzekutive, si dhe në shkencë, ekonomi, drejtësi, arsim, kulturë, shëndetësi, ushtri etj...

Edhe pse të pavlerësuara si e sa duhet, si dhe në kushte pabarazie gjinore, megjithatë janë në një numër të konsiderueshëm gratë që janë ndërtuese të shoqërisë, me të njëjtat vlera si dhe meshkujt. Kurrë s'duhet harruar se gjatë historisë ka pasur shumë vajza të reja, bashkëshorte, nëna që me punën e tyre, bazuar në intelekt, arsim, profesion, kurajë, guxim e vetëmohim, janë bërë shembuj virtyti që kanë dhënë vlera të njëjta apo dhe më të avancuara sesa meshkujt. Në këtë mënyrë ato kanë krijuar modele që duhen ndjekur nga bashkëkohësit apo të merren si nxitje për të thyer konceptet patriarkale të shoqërisë njerëzore.

Gratë kanë përcaktuar rrjedhën e ngjarjeve dhe format e kulturës njerëzore. Ne filluam, themeluam, qeverisëm, krijuam artin e madh, luftuam për të drejtat tona dhe të njerëzve tanë. Këto janë gratë të nxjerra jashtë nga historia, historitë e tyre të harruara, të shtrëmbëruara. Ajo që nuk dimë për këto gra është fortësisht e rënduar nga mungesa e informacionit në shoqëri, të cilat akordojnë pushtetin e femrës në jetën publike, diplomaci, fe, mjekësi dhe gjithashtu art, e shohin si strukturë familjare dhe trashëgimi.

Guximi femëror në shumë shoqëri është kërkuar thjesht për të mbrojtur lirinë personale dhe vendosmërinë, duke krijuar hapësirë për të vepruar, pavarësisht pengesave patriarkale.

Ka shumë tregime historike për gratë luftëtare, për gra që shumë shpesh luftuan për të mbrojtur shtëpitë e tyre, njerëzit dhe fshatrat e tyre. Gjithsesi, është shumë e vështirë për shumë njerëz sot, të konceptojnë gjithë këtë autoritet femëror, në shumë shoqëri gratë kanë pushtetin formal për të vënë veto mbi vendimin për të shkuar në luftë.

Gra që hapur shprehin fuqinë e tyre, njohuritë, dijet, duke marrë mirënjohje dhe nderim publik. Por, gjithashtu gra që veprojnë për të menaxhuar pushtetin në shoqëri, që mundohen ta limitojnë atë apo të dekretojnë nënshtrimin e gruas, aty ku lidshipi i tyre stigmatizohet apo kreativiteti i tyre të përbuzet. Dhe gra që i rezistojnë dhe dënojnë traditat dhe regjimet tiranike. Që thyjnë Rregullat për të kundërshtuar padrejtësitë ligjore dhe fetare të autoriteteve. Që ndjekin pikëpamjet e tyre, pavarësisht nga kostot personale.

Kjo është Femra!

REPowerEU - Veprim i përbashkët europian për energji më të përballueshme, të sigurt dhe të qëndrueshme

Presidentja e Komisionit European, Ursula von der Leyen: Ne duhet të bëhemi të pavarur nga nafta, qymyri dhe gazi rus

Komisioni European ka propozuar një përmbledhje të një plani për ta bërë Europën të pavarur nga lëndët djegëse fosile ruse shumë përpara vitit 2030, duke filluar me gazin, në dritën e pushtimit rus të Ukrainës.

Ky plan përshkruan gjithashtu një sërë masash për t'iu përgjigjur rritjes së çmimeve të energjisë në Europë dhe për të rimbushur rezervat e gazit për dimrin e ardhshëm. Europa po përballet me rritjen e çmimeve të energjisë për disa muaj, por tani pa-siguria në furnizim po e përkeqëson problemin. REPowerEU do të kërkojë të diversifikojë furnizimet me gaz, të përshpejtojë nxjerrjen e gazeve të rinovueshme dhe të zëvendësojë gazin në ngrohje dhe prodhimin e energjisë. Kjo mund të zvogëlojë kërkesën e BE-së për gazin rus me dy të tretat para fundit të vitit.

Presidentja e Komisionit Ursula von der Leyen tha: "Ne duhet të bëhemi të pavarur nga nafta, qymyri dhe gazi rus. Ne thjesht nuk mund të mbështetemi te një furnizues që na kërcënon në mënyrë të qartë. Ne duhet të veprojmë tani për të zbutur ndikimin e rritjes së çmimeve të energjisë, për të diversifikuar furnizimin tonë me gaz për dimrin e ardhshëm dhe për të përshpejtuar tranzicionin e energjisë së pastër. Sa më shpejt të kalojmë tek burimet e rinovueshme dhe hidrogjeni, të kombinuara me më shumë efikasitet energjetik, aq më shpejt do të jemi vërtet të pavarur dhe do të zotërojmë sistemin tonë energjetik. Unë do të diskutoj idetë e Komisionit me liderët europianë në Versajë më vonë këtë javë dhe më pas do të punoj për t'i zbatuar ato me shpejtësi me ekipin tim."

Zëvendës-Presidenti Ekzekutiv për Marrëveshjen e Gjellbër Europiane, Frans Timmermans tha: "Është koha që të trajtojmë dobësitë tona dhe të bëhemi me shpejtësi më të pavarur në zgjedhjet tona të energjisë. Le të futemi në energjinë e rinovueshme me shpejtësi rrufeje. Burimet e rinovueshme janë një burim i lirë, i pastër dhe potencialisht i pafund energjie dhe në vend që të financojnë industrinë e karburanteve fosile diku tjetër, ato krijojnë vende pune këtu. Lufta e Putinit në Ukrainë tregon urgjencën e përshpejtimit të tranzicionit tonë të energjisë së pastër."

Komisioneri për Energjinë, Kadri Simson, tha: "Invazioni rus i Ukrainës ka përkeqësuar situatën e sigurisë së furnizimit dhe ka çuar çmimet e energjisë në nivele të paprecedentë. Për javët e mbetura të këtij dimri, Europa ka sasi të mjaftueshme gazi,



por ne duhet të rimbushim rezervat tona urgjentisht për vitin e ardhshëm. Prandaj Komisioni do të propozojë që deri më 1 tetor, depozitimi i gazit në BE duhet të mbushet deri në të paktën 90%. Ne kemi përshkruar gjithashtu rregullimin e çmimeve, ndihmën shtetërore dhe masat tatimore për të mbrojtur familjet dhe bizneset europiane kundër ndikimit të çmimeve jashtëzakonisht të larta."

Masa emergjente për çmimet e energjisë dhe depozitimin e gazit

"Paketa e mjeteve për çmimet e energjisë" e Komisionit, nga tetori i kaluar ka ndihmuar Shtetet Anëtare të zbusin ndikimin e çmimeve të larta te konsumatorët e cenueshëm dhe mbetet një kornizë e rëndësishme për masat kombëtare. Sot Komisioni po u paraqet Shteteve Anëtare udhëzime shtesë, duke konfirmuar mundësinë për të rregulluar çmimet në rrethana të jashtëzakonshme dhe duke përcaktuar se si Shtetet Anëtare mund të rishpërndajnë të ardhurat nga fitimet e larta të sektorit të energjisë dhe tregtimi i emetimeve për konsumatorët. Rregullat e BE-së për Ndhimën Shtetërore u ofrojnë gjithashtu shteteve anëtare opsione për të ofruar mbështetje afatshkurtër për kompanitë e prekura nga çmimet e larta të energjisë dhe për të ndihmuar në uljen e ekspozimit të tyre

ndaj paqëndrueshmërisë së çmimeve të energjisë në periudhën afatmesme dhe afatgjatë. Pas një konsultimi mbi amendamentet e synuara në Udhëzimet e Ndhimës Shtetërore të Sistemit të Tregtisë së Emisioneve, Komisioni do të konsultohet gjithashtu me Shtetet Anëtare për nevojat dhe qëllimin e një Kornizë të Përkohshme të Krizave të Ndhimës Shtetërore për të dhënë ndihmë për kompanitë e prekura nga kriza, në veçanti ata që përballen me kosto të larta të energjisë.

Komisioni synon të paraqesë deri në prill një propozim legjislativ që kërkon që depozitat nëntokësore të gazit në të gjithë BE-në të mbushen deri në të paktën 90% të kapacitetit të tij deri më 1 tetor të çdo viti. Propozimi do të përfshinte monitorimin dhe zbatimin e niveleve të plotësimit dhe ndërtimin e marrëveshjeve të solidaritetit midis Shteteve Anëtare. Komisioni vazhdon hetimin e tij në tregun e gazit në përgjigje të shqetësimeve rreth shtrembërimeve të mundshme të konkurrencës nga operatorët, veçanërisht Gazprom.

Për të adresuar çmimet në rritje të energjisë, Komisioni do të shqyrtojë të gjitha opsionet e mundshme për masat emergjente për të kufizuar efektin ngjitës të çmimeve të gazit në çmimet e energjisë elektrike, siç janë kufijtë e përkohshëm të çmimeve. Ai gjithashtu do të vlerësojë opsionet për të optimizuar dizajnin e tregut të

energjisë elektrike duke marrë parasysh raportin përfundimtar të Agjencisë së BE-së për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë (ACER) dhe kontributet e tjera mbi përfitimet dhe disavantazhet e mekanizmave alternativë të çmimeve për të mbajtur energjinë elektrike të përballueshme, pa ndërprerë furnizimin dhe investime të mëtejshme në tranzicionin e gjellbër.

REPowerEU - Eliminimi i varësisë nga gazi rus përpara vitit 2030

Heqja graduale e varësisë së Be-së nga lëndët djegëse fosile nga Rusia mund të bëhet shumë përpara vitit 2030. Për ta bërë këtë, Komisioni propozon zhvillimin e një plani REPowerEU, që do të rrisë qëndrueshmërinë e sistemit energjetik në mbarë BE-në bazuar në dy shtylla: Diversifikimi i furnizimeve me gaz, nëpërmjet importeve më të larta të Gazit Natyror të Lëngshëm (LNG) dhe tubacioneve nga furnizues jo-rusë, dhe vëllime më të mëdha të prodhimit dhe importeve të biometanit dhe hidrogjenit të rinovueshëm; dhe, duke reduktuar më shpejt përdorimin e lëndëve djegëse fosile në shtëpitë, ndërtesat, industrinë dhe sistemin tonë energjetik, duke rritur efikasitetin e energjisë, duke rritur burimet e rinovueshme dhe elektrifikimin, dhe duke adresuar pengesat e infrastrukturës.

Zbatimi i plotë i propozimeve të Komisionit "Fit for 55", tashmë do të reduktonte konsumin tonë vjetor të gazit fosil me 30%, ekuivalente me 100 bilion metra kub (bcm), deri në vitin 2030. Me masat në planin REPowerEU, ne mund të heqim gradualisht të paktën 155 bilion metra kub përdorim të gazit fosil, i cili është i barabartë me vëllimin e importuar nga Rusia në vitin 2021. Gati dy të tretat e këtij reduktimi mund të arrihet brenda një viti, duke i dhënë fund varësisë së tepërt të BE-së nga një furnizues i vetëm. Komisioni propozon të punojë me Shtetet Anëtare për të identifikuar projektet më të përshtatshme për të rimbushur këto objektiva, duke u mbështetur në punën e gjerë të bërë tashmë në Planet Kombëtare të Rimëkëmbjes dhe Rezistencës.

Realiteti i ri gjeopolitik dhe i tregut të energjisë kërkon që ne të përshpejtojmë në mënyrë drastike tranzicionin e energjisë së pastër dhe të rrisim pavarësinë energjetike të Europës nga furnizuesit jo të besueshëm dhe lëndët djegëse fosile të paqëndrueshme.

Pas pushtimit të Ukrainës, rasti për një tranzicion të shpejtë të energjisë së pastër nuk ka qenë kurrë më i fortë dhe më i qartë. BE-ja importon 90% të konsumit të saj të gazit, me Rusinë që siguron rreth 45% të këtyre importeve, në nivele të ndryshme nga shtetet anëtare. Rusia gjithashtu përbën rreth 25% të importeve të naftës dhe 45% të importeve të qymyrit.

Paketa e mjeteve të Komisionit për Çmimet e Energjisë e tetorit 2021 ka ndihmuar qytetarët dhe bizneset të përballen me çmimet e larta të energjisë muajt e fundit. 25 Shtete Anëtare kanë miratuar masa në përputhje me kutinë e mjeteve, të cilat tashmë po lehtësojnë faturat e energjisë për mbi 70 milionë konsumatorë familjarë dhe disa milionë ndërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme.

Komisioni vazhdon të punojë me fqinjët dhe partnerët në Ballkanin Perëndimor dhe në Komunitetin e Energjisë, të cilët ndajnë varësinë e BE-së nga karburantet fosile dhe ekspozimin ndaj rritjes së çmimeve, ndërkohë që janë angazhuar për të njëjtat synime klimatike afatgjata. Për Ukrainën, Moldavinë dhe Gjeorgjinë, BE-ja është e gatshme të ofrojë mbështetje për të siguruar energji të besueshme dhe të qëndrueshme. Përpjekja e vazhdueshme për të siguruar një sinkronizim emergjent të rrjeteve elektrike të Ukrainës dhe Moldavisë me rrjetin europian kontinental është një shenjë e qartë e këtij angazhimi.

Ditët e Epopesë së madhe të UÇK-së!

PROF. ASOC. DR. ZAHO GOLEMI

Sot është dita e së vërtetës dhe krenarisë kombëtare, një ditë historike! Është dita e epopesë së UÇK-së, shpëtimtares së shqiptarëve të përtej Drinit, është simbolika e shekujve që shqiptarët e Kosovës e pritën jo pak por një shekull. UÇK-ja është krenari e të gjithë shqiptarëve që nisi si forcë e sigurisë kombëtare, si një burim i pashtershëm lirie. Në fakt janë tri ditë të përkujtuese të Epopesë së madhe të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, sepse më 5, 6, e 7 Mars të 1998-ës, ishte zhvilluar njëra ndër betejat më vitale dhe më të rëndësishme të UÇK-së kundër agresionit brutal ushtarak të pushtuesve serbë. Trupat militare serbe sulmuan familjen e Adem Jasharit dhe pas një përballjeje heroike në Prekazin e atdhetarisë u shkrua epike qëndrese, u vranë 55 vetë nga të cilët 20 fëmijë e gra. Këtu në këtë luftë ra legjendari i UÇK-së Adem Jashari, vëllai i tij Hamëz Jashari dhe babai i tyre, Shaban Jashari. Prekazi u bë kthesa madhore e zgjidhjes së çështjes të Shqiptarëve përtej Drinit, e Dardanisë sonë.

Kush ishte Adem Jashari? Adem Jashari ishte lindur më 28 Nëntor 1955, në një ditë me ditëlindjen e flamurit. Ai gjithë jetën punoi e luftoi për flamurin, që kërkoi një Kosovë të pavarur, por edhe një ëndërr që ta shihte Shqipërinë të bashkuar. Ai u trupëzua më flamurin kombëtar dhe ra për këtë flamur në epopenë e madhe heroike të 5 deri më 7 mars 1998. Kombi shqiptar ka sot një nderim të veçantë për komandantin legjendar Adem Jashari, prijësi i heronjve të pavdekshëm të kombit.

Marsi i vitit 1998, ishte rrethimi i tretë i kullës së Jasharëve në Prekaz, ku përgjakja e tre ditëve është pjesë e martirizimit të shqiptarëve. Fakt është se rreth e përfaqë Fabrikës së Municionit në Skënderaj, më 3 e 4 mars 1998, ishin dislokuar forca të shumta ushtarake por edhe forca e mjete të artillerisë së rëndë. Gjithashtu policia serbe kishte bërë përforsime të shumta nëpër të gjitha postbllloqet e saj në Drenicë. Në orën 5.30 minuta të datës 5 mars, artilleria serbe, nga Fabrika e Municionit, fillon gjuajtjet në drejtim të Kullës së Shaban Jasharit, por dhe të gjithë Jasharëve të tjerë. Krismën e armëve dhe sidomos kundërpërgjigjen e dëgjoi gjithë shqiptaria. Qëndresa ishte heroike titanike e kryetrimave në Prekaz, por kushtimi ishte dhënë tashmë në mbarë shqiptarinë, në të gjitha trojet e Shqipërisë dhe në diasporën shqiptare. Legjendari Adem Jashari, kishte marrë vendimin historik, tepër të vështirë, ndër më të dhembshmit, të pakrahasueshëm në historinë shqiptare, për të qëndruar



trimërisht përballë sulmit dhe për të mos u dorëzuar për së gjalli. Adem Jashari kishte thënë: “Vrastarët nuk do të kalojnë, veçse mbi trupin tim të vdekur!”, dhe historia më e re e Prekazit ishte bërë flamur frymëzimi për brezat. Ai ngeli pishtari i pashuar që udhëhiqte luftën si frymëzues betejash, i çimentuar njësh me lirinë. Lajmi për rënien e legjendarit Adem Jashari dhe të njëzetë pjesëtarëve të familjes së ngushtë të Shaban Jasharit, por edhe të 39 të tjerëve nga familja e madhe e Jasharajve, që gjendeshin në Prekaz, kishte prekur shpirtin e çdo shqiptari lirisht. Dhimbje dhe krenari për një akt ekstrem të sakrifikuar për lirinë e një kombi të tërë, një veprim frymëzues i pakrahasueshëm. Prekazi u kthye në kullën e përjetshme të lirisë së shqiptarizmit, flakadani i qëndresës, prushi i përjetshëm i atdhetarisë, që përbashkon shqiptarinë, anëmbanë trojeve etnike të Shqipërisë dhe në diasporën shqiptare të shpërndarë në të katër anët e globit. Akti vetë-flijues i Adem Jasharit, Hamëz Jasharit, Shaban Jasharit, Osman Gecit, Hamit Jasharit, Salë Jasharit, Faik Jasharit, Halil Jasharit, Ali Jasharit, Sherif Jasharit, Hajzer Jasharit, Ramiz Jasharit, Kajta Jasharit dhe i sa e sa të tjerëve, i kishte dhënë frymëzim dhe im-

Adem Jashari ishte lindur më 28 Nëntor 1955, në një ditë me ditëlindjen e flamurit. Ai gjithë jetën punoi e luftoi për flamurin, që kërkoi një Kosovë të pavarur, por edhe një ëndërr që ta shihte Shqipërinë të bashkuar. Ai u trupëzua më flamurin kombëtar dhe ra për këtë flamur në epopenë e madhe heroike të 5 deri më 7 mars 1998. Kombi shqiptar ka sot një nderim të veçantë për komandantin legjendar Adem Jashari, prijësi i heronjve të pavdekshëm të kombit. Marsi i vitit 1998, ishte rrethimi i tretë i kullës së Jasharëve në Prekaz, ku përgjakja e tre ditëve është pjesë e martirizimit të shqiptarëve.

pulse flakës së luftës për liri. Osh-tima e shekujve “O, prite Azem Galicën...”, u shndërrua në “Prite, prite Adem Jasharin!”, devizë për të cilën u luftua dhe u fituan betejat, nga bijtë e bijat e Kosovës martire, luftëtarët dhe luftëtare të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e ushtrisë-shpresë të popullit dhe tmerrit për armikun. Gjatë luftës emrin e Adem Jasharit, e mbante Brigada 111 e UÇK-së. Në përvjetorin e pavarësisë shqiptare, por dhe datëlindjen e krye heroit, më 28 nëntor 1998, Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Jasharin e shpall Komandant Legjendar të UÇK-së, ndërsa sot këtë emër të ndritur “Adem Jashari” e mban

Garda e Republikës së Kosovës. Ka hyrë në histori thënia e krye-administratorit të parë të Kosovës, francezi Bernard Kushner, që me rastin e një vizite në Prekaz, kishte deklaruar: “Po të kishte çmim Nobel për liri, ai çmim do t’i takonte familjes Jashari të Prekazit”. Për komandantin Adem Jashari janë shkruar libra, drama, broshura, jetëshkrime nga shumë intelektualë shqiptarë dhe të huaj, ka dhjetëra e qindra shkrime të autorëve të ndryshëm, është objekt hulumtimi në dhjetëra e qindra Konferenca shkencore e sesione shkencore brenda dhe jashtë Kosovës, janë emërtuar shumë sheshe dhe rrugë qytetesh në Prishtinë, në Tiranë, në Gjirokastër dhe kudo

në trojet e Shqipërisë Etnike, është realizuar kompleksi memorial “Adem Jashari”, në Prekaz. Adem Jashari është përjetësuar në institucione të shumta edukative, arsimore e shkencore, në trojet shqiptare. Adem Jashari është emri më i frekuentuar shqiptar në mediat shqiptare dhe botërore. Portreti i Adem Jasharit gjendet kudo në Kosovë, Shqipëri, tek shqiptarët në emigracion.

Amanetin e Adem Jasharit e përmbushi UÇK-ja me luftën e saj të drejtë për çlirim kombëtar. Vepra më heroike e shqiptarëve ishte UÇK-ja dhe lufta e saj, ajo e cila e ndërkombezarizoi si kurrë më parë çështjen kombëtare shqiptare në arenën botërore.

UÇK-ja diti që me sigurinë dhe vendosmërinë e saj të detyronte Fuqitë më të Mëdha të globit, që të mblidheshim në një konferencë ndërkombëtare, në kështjellën e Rambujesë, në Francë në shkurtin e 1999, posaçërisht për çështjen shqiptare. Përfaqësues të shqiptarëve u bënë të njohur botës të vërtetat mbi tragjedinë me shqiptarët dhe me trojet e tyre, tragjedi që kishin ndodhur më parë në Shën Stefan, në Berlin, Londër, etj., por këtë radhë më ne shqiptarët ishte edhe aleati ynë strategjik, Fuqia më e Madhe e botës SHBA.

UÇK-ja e të gjitha trojeve shqiptare e organizuar, dinjitoze dhe e vendosur u bë struktura e një force tokësore të NATO-s në teren, ndërkohë që NATO ndërhyri ushtarakisht më 24 marsin e 1999-ës. Ushtria e Kosovës ishte një misionare lirie me karakter çlirimtar gjithëkombëtar. UÇK-ja u kthye në aktorin dhe faktorin misionar për çlirimin e Kosovës. NATO u shndërrua në Forca ajrore e UÇK-së, ndërsa UÇK ishte këmbësoria solide dhe zbulimi në teren i forcave të NATO-s. Faktori NATO nën drejtimin e SHBA-së, dhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës, janë misionarët e së drejtës, në një mision historik të kryer, bashkëpunues, të njohur dhe legjitimuar botërisht, dhe sa herë kujtohet epopeja e madhe e kreshnikëve të Prekazit përkujtohet NATO dhe UÇK-ja, të lidhur në funksion të lirisë dhe të drejtës së kombeve të shtypur, që tashmë janë pjesë e historisë sonë Kombëtare. Ky unitet do të shpaloset padyshim edhe në kërkimet shkencore të elitës intelektuale historiografike këtej dhe matanë Drinit, që do të mblidhen për sesionin shkencor me temë: “Ushtria Çlirimtare e Kosovës - vlerë kombëtare”. Lavdi e përjetshme familjes Jashari dhe gjithë dëshmorëve të kombit shqiptar! Lavdi Dëshmorëve të Prekazit, të UÇK-së dhe të mbarë kombit tonë!

8

MARSI

Vitet e fundit janë bërë hapa të mëdhenj
në drejtim të barazisë gjinore në FA

